



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 555 Akti

Nr. 605 Vendimi  
Tiranë, më 21.12.2022

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Roland Ilia</b>	Kryesues
<b>Brunilda Bekteshi</b>	Relatore
<b>Pamela Qirko</b>	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Albana Plaka, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, në datën 19.12.2022, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Armida Hamiti (Moçka)**, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b, paragrafi 5, neni Ç, paragrafi 1 dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998;

**Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë**, e ndryshuar;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisionere Brunilda Bekteshi, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Armida Hamiti (Moçka), me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, referuar pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni).
2. Referuar neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK); dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).
3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në zbatim të germës “b” të pikës 7 të nenit 3 dhe pikës 9 të nenit 3 të rregullores “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni ka zhvilluar shortin në datën 15.6.2020, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit Armida Hamiti (Moçka) do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Brunilda Bekteshi, Pamela Qirko dhe Roland Ilia. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Brunilda Bekteshi.
4. Trupi gjykues, pasi kishte administruar të tria raportet e përcjella nga organet ndihmëse, sipas parashikimeve të neneve 31 - 44 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 1, në datën 19.6.2020, ka vendosur: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të po këtij ligji; (ii) me mirëkuptim të caktojë kryesues të trupit gjykues komisionerin Roland Ilia. Gjithashtu, në këtë mbledhje anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit Armida Hamiti (Moçka), e cila deklaroi<sup>1</sup> gjithashtu se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë prej anëtarëve të trupit gjykues.
5. Komisioni, me vendimin nr. 2, datën 20.9.2022, në bazë të pikës 2 të vendimit nr. 3, datë 8.1.2020, të Komisionit, “Për dhënien e aksesit në dosjet e arkivuara trupave gjyqësore që shqyrtojnë subjektet e rivlerësimit me lidhje familjare midis tyre”, vendosi administrimin e dokumentacionit të plotë që i përkiste dosjes së përcjellë nga ILDKPKI-ja për subjektin e rivlerësimit, z. G.H, bashkëshorti i subjektit.
6. Komisioni, në datën 2.12.2022, me vendimin nr. 3, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit Armida Hamiti (Moçka), për të tria kriteret e rivlerësimit: kriterin e pasurisë; kontrollin e figurës; dhe vlerësimin e aftësive profesionale, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, të paraqesë pretendimet e saj brenda 12 ditëve nga marrja e njoftimit me postë elektronike, si dhe për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.
7. Në datën 2.12.2022 subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën, brenda 12 ditëve. Brenda afatit të caktuar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit

<sup>1</sup> Referohuni *email*-it datë 24.7.2020, në dosjen e Komisionit.

dërgoi shpjegimet dhe provat mbi rezultatet e hetimit administrativ në mënyrë elektronike dhe zyrtare.

**8.** Trupi gjykues, pas administrimit të dokumentacionit të depozituar nga subjekti në qëndrimin e saj, në datën 15.12.2022, me vendimin nr. 4, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit Armida Hamiti (Moçka) në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, duke e njoftuar me anë të postës elektronike se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 19.12.2022, në orën 10:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

**9.** Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit Armida Hamiti (Moçka) u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova. Gjatë seancës dëgjimore subjekti i rivlerësimit shprehu qëndrimin lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe me procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

**10.** Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Armida Hamiti (Moçka). Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore të datës 19.12.2022, për të rifilluar në datën 21.12.2022 për shpalljen e vendimit.

## **III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

**11.** Znj. Armida Hamiti (Moçka) ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur, kur është kërkuar, sipas afatit të përcaktuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj saj.

## **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**12.** Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” sipas krerëve IV, V dhe VI të këtij ligji. ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror. DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit. KLP-ja është organi ndihmës i ngarkuar me ligj për të paraqitur një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar në lidhje me vlerësimin profesional. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese<sup>2</sup> dhe

---

<sup>2</sup> Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5 të nenit 179/b të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016 parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Posaçëm i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues,

kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

## **A. VLERËSIMI I PASURISË**

### **A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja**

**13.** ILDKPKI-ja, me raportin nr. \*\*\* prot, datë 23.7.2018, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Armida Hamiti (Moçka), në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, dhe në datën 30.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, si për subjektin e rivlerësimit, ashtu edhe për personat e lidhur me të, për vlerësimin e pasurisë ky institucion ka konstatuar se: (i) deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin; (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; si dhe (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

### **A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni**

**14.** Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklarinimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të bëra me anë të komunikimit elektronik; (ç) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, pas mbylljes së hetimit administrativ; si dhe (d) shpjegimet e dhëna në seancë dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

**15.** Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarinimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; si dhe (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarinimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

**16.** Mbi pasuritë e deklaruara në deklaratën *Vetting*, sipas formularit (shtojca nr. 2), datë 25.1.2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, nga hetimi rezultoi se subjekti rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë deklaruar në deklaratën *Vetting* pasuritë si vijon:

---

*organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.*

**17. Pasuria tokë arë me sip. 5.000 m<sup>2</sup>**, sipas Aktit të Marrjes së Tokës në Përdorim, me nr. regjistri akti \*\*\*, datë 11.10.1994, (në bashkëpronësi me familjen bujqësore, të përbërë nga 5 anëtarë), i peregjistruar në regjistrat publikë, ndodhur në fshatin A, Vlorë. Pjesa takuese: 20%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës Aktin<sup>3</sup> e Marrjes së Tokës në Përdorim nr. \*\*\* regjistri, datë 11.10.1994, për tokë arë me sip. 5.000 m<sup>2</sup> në fshatin A, në emër të shtetasit LL.M.

**17.1** Nga hetimi i kryer nga Komisioni, kjo pasuri konfirmohet në përdorim, përfituar sipas ligjit nr. 7501/1991, me AMTP-në nr. akti \*\*\*, datë 11.10.1994, në fshatin A, në emër të babait të subjektit të rivlerësimit, z. LL.K.M. Sipas vërtetimit datë 20.10.2016, të Njesisë Administrative N, vërtetohet se babai i subjektit të rivlerësimit, z. LL.K.M, si punëtor i ish-NB-së A, ka përfituar tokë arë në përdorim me sip. 5.000 m<sup>2</sup>, bazuar sipas numrit të regjistrimit të aktit \*\*\*. Sipas certifikatës<sup>4</sup> së gjendjes familjare datë 1.8.1991, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, në kohën e përfitimit të kësaj pasurie, ka qenë anëtare e trungut familjar dhe, për rrjedhojë, ajo është bashkëpronare e familjes bujqësore, duke pasur të njëjtat të drejta dhe detyrime së bashku me anëtarët e tjerë të familjes.

**17.2** Komisioni, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar, konstaton se subjekti ka deklaruar me vërtetësi e saktësi këtë pasuri dhe se nuk ngrihen dyshime lidhur me përfitimin e saj.

**18. Pasuria me sip. 18.619 m<sup>2</sup>**, sipas Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi nr. \*\*\*, datë 6.3.1993, (në bashkëpronësi të familjes bujqësore të përbërë nga 5 anëtarë), fshati M, Vlorë, i peregjistruar në regjistrat publikë, nga të cilat sipërfaqja prej 444 m<sup>2</sup> është shpronësuar me VKM-në Nr. 482, datë 23.6.2010. Pjesa takuese: 20%. Të ardhura nga shpronësimi i pronës me VKM-në Nr. 482, datë 23.6.2010, për shkak të ndërtimit të autostradës Levan-Vlorë në vlerën 710.400 lekë. Pjesa takuese: 20%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente<sup>5</sup>.

**18.1** Nga hetimi administrativ i Komisionit rezultoi se kjo pasuri konfirmohet në emër të babait të subjektit të rivlerësimit, z. LL.K.M, nga fshati M, përfituar sipas ligjit nr. 7501/1991, “Për tokën”, me AMTP-në nr. akti \*\*\*, datë 6.3.1993. Edhe sipas vërtetimit datë 20.10.2016, të Njesisë Administrative N, Vlorë, vërtetohet se babai i subjektit të rivlerësimit LL.K.M është banor i fshatit M dhe se nga zbatimi i këtij ligji ka përfituar në këtë fshat tokë bujqësore, sipas ngastrave të dhëna në AMTP-në nr. \*\*\* të llojit: (i) arë me sip. 18.619 m<sup>2</sup>, (ii) arë me sip. 14.519 m<sup>2</sup>, (iii) vresht me sip. 1.100 m<sup>2</sup>, si dhe (iv) ullishtë me sip. 3.000 m<sup>2</sup>. Sipas certifikatës<sup>6</sup> së gjendjes familjare datë 1.8.1991, rezultoi se subjekti i rivlerësimit në kohën e përfitimit të kësaj pasurie ka qenë anëtare e trungut familjar. Në këto rrethana, Komisioni konstatoi se bazuar në ligjin nr. 7501/1991, “Për tokën”, është përmbushur kriteri ligjor për të qenë anëtare/bashkëpronare e familjes bujqësore, duke pasur të njëjtat të drejta/përfitime dhe detyrime së bashku me anëtarët e tjerë të familjes bujqësore.

**18.2** Lidhur me të ardhurat e deklaruara nga subjekti nga shpronësimi i pronës me VKM-në Nr. 482, datë 23.6.2010, Komisioni konstatoi se me vendimin nr. 482, datë 23.6.2010, të Këshillit të Ministrave, për disa ndryshime në vendimin nr. 2007, datë 21.2.2008, të Këshillit të Ministrave,

<sup>3</sup> Shihni dokumentacionin në aneksin nr. \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>4</sup> Depozituar me pyetësin nr. 2, datë 28.10.2022, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>5</sup> Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi nr. \*\*\* regjistri, datë 6.3.1993, për tokë arë me sip. 14.519 m<sup>2</sup>, vresht, me sip. 1.100 m<sup>2</sup> dhe ullishtë me sip. 3.000 m<sup>2</sup>, në fshatin M, në emër të shtetasit LL.M; vendim nr. 482, datë 23.6.2010, i Këshillit të Ministrave, për disa ndryshime në vendimin nr. 2007, datë 21.2.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilët preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Levan-Vlorë”, të ndryshuar. Bashkëlidhur lista e të shpronësuarve sipas të cilit shtetasi LL.M shpronësohet në vlerën 710.400 lekë. Referuar aneksin nr. \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>6</sup> Depozituar nga subjekti i rivlerësimit me pyetësin nr. 2, datë 28.10.2022.

“Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilët preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Levan-Vlorë”, të ndryshuar, është miratuar shpronësimi i këtij segmenti rrugor, si dhe lista e të shpronësuarve sipas disa kategorive, të cilët kompensohen nga ky shpronësim.

**18.3** Sipas listës shoqëruese të VKM-së, lidhur me këtë shpronësim në interes publik, konstatohet se babai i subjektit të rivlerësimit, z. LL.K.M, është një ndër subjektet përfituese (i listuar me nr. \*\*\*) nga shpronësimi i këtij segmenti rrugor. Në listë konfirmohet nga ZVRPP-ja se pasuria është e llojit “arë”, me nr. \*\*\*, në z. k. \*\*\*, me sip. 400 m<sup>2</sup>, vlerësuar në vlerën 701.400 lekë.

**18.4** Nga verifikimi i llogarive bankare në “Raiffeisen Bank” rezultoi se në datën 10.11.2008, në emër e për llogari të z. LL.K.M, është transferuar shuma 709.689,6 lekë, sipas shkresës nr. \*\*\*, datë 6.11.2008, të Ministrisë së Financave, për sipërfaqen e tokës bujqësore, për të cilën ai është shpronësuar.

**18.5** Komisioni, nga verifikimi i të dhënave të administruara, vërejtji paqartësi lidhur me pagesën e kryer në favor të babait të subjektit të rivlerësimit, për sa kohë subjekti ka deklaruar pasurinë të paregjistruar.

**18.6** Komisioni e ka pyetur<sup>7</sup> subjektin lidhur me këtë konstatim, e cila në përgjigje të saj ka shpjeguar se: *“Bazuar në dispozitat e ligjit nr. 7501/1991, ‘Për tokën’, kjo sipërfaqe kategorizohet tokë bujqësore... prej meje në deklaratën Vetting është deklaruar: ‘Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi nr. \*\*\*, datë 6.3.1993, me sip. 18.619 m<sup>2</sup>’. Në lidhje me shumën prej 710.400 lekësh, e deklaruar si e ardhura të përfituara nga shpronësimi për qëllime të ndërtimit të autostradës Levan - Vlorë, sipas VKM-së Nr. 482, datë 23.6.2010, ky përfitim është kryer me transaksion bankar, veprim i cili ka ndodhur në kohë reale, duke kaluar në llogarinë bankare të babait, z. LL.K.M, në datën 10.11.2008, pranë bankës së nivelit të dytë ‘Raiffeisen Bank’. Këto të ardhura më pas janë tërhequr nga babai dhe janë ruajtur në shtëpi”*. Për sa i përket regjistrimit të kësaj pasurie të paluajtshme, objekt shpronësimi, subjekti ka sqaruar se ka qenë një lapsus nga ana e saj mospasqyrimi i faktit të regjistrimit në regjistrat publikë në Zyrën Vendore të Pasurive të Paluajtshme Vlorë në kohën që u krye shpronësimi. Subjekti ka deklaruar se akti i shpronësimit dhe përfitimi i të ardhurave të realizuara nga shpronësimi ka ndodhur në kohën që ajo nuk ka qenë subjekt deklarues.

**18.7** Nga aktet e administruara për shpronësimin e kësaj pasurie, Komisionit i rezultoi se konfirmohet sipërfaqja e shpronësuar prej 400 m<sup>2</sup>, e llojit “tokë bujqësore arë”, me nr. pasurie \*\*\*, e ndodhur në z.k. \*\*\*. Pra këto të dhëna janë si rezultat i regjistrimit të pasurisë së paluajtshme në regjistrat publikë pranë ZVRPP-së Vlorë, e cila më pas është shpronësuar.

**18.8** Në analizë të dokumentacionit të administruar dhe të dhënave të pasqyruara, trupi gjykues, në konsideratë të fakteve të dala, konstaton se konfirmohet: (i) përfitimi i kësaj pasurie me AMTP-në nr. akti \*\*\*, datë 6.3.1993, në pronësi të familjes bujqësore dhe e regjistruar nga ZVRPP-ja Vlorë, (ii) regjistrimi i sipërfaqes së shpronësuar prej 400 m<sup>2</sup>, e llojit “arë”, si dhe (iii) përfitimi i të ardhurave nga ky shpronësimi<sup>8</sup> i kësaj pasurie në vlerë monetare nëpërmjet transaksionit bankar, pavarësisht shpjegimeve të subjektit. Në analizë të këtyre fakteve, Komisioni çmon se deklarimi i

<sup>7</sup> Me pyetësorin nr. 2, datë 28.10.2022, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>8</sup> Sipas vendimit nr. 482, datë 23.6.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 2007, datë 21.2.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilët preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Levan-Vlorë”, të ndryshuar.

kësaj pasurie në deklaratën *Vetting*, nën termin “i paregjistruar”, në regjistrat publikë mbetet një pasaktësi formale në deklaram, pa ndikim në procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit.

**19. Apartament banimi me sip. 106 m<sup>2</sup> (plus 10 m<sup>2</sup> ambient i përbashkët), Vlorë,** regjistruar në ZVRPP-në Vlorë me nr. pasurie \*\*\*, blerë me kontratën e porosisë datë 4.5.2011 dhe kontratën përfundimtare të shitjes nr. \*\*\*, datë 10.9.2012. Vlera: 50.000 euro, me të ardhura të siguruara nga aktiviteti i familjes bujqësore prej vitit 1994 deri në vitin 2011. Apartamenti është në bashkëpronësi të familjes bujqësore të origjinës. Pjesa takuese: 20%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente<sup>9</sup>.

## Hetimi i Komisionit

**19.1** Subjekti i rivlerësimit e deklaroi për herë të parë këtë pasuri në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës, të dorëzuar në datën 14.12.2011, me përshkrimin “Apartament banimi, kontratë porosisë datë 4.5.2011, me sip. 116 m<sup>2</sup>. Lagjja ‘\*\*\*’, Vlorë. Vlera: 50.000 euro”. Subjekti e ka deklaruar këtë pasuri me të njëjtat të dhëna edhe në DPV-në e po këtij viti.

**19.2** Sipas dokumentacionit të administruar në dosje, kjo pasuri konfirmohet në emër të subjektit të rivlerësimit, me certifikatën për vërtetim pronësie, lëshuar në datën 17.9.2012<sup>10</sup>.

**19.3** Në lidhje me origjinën e kësaj pasurie, nga verifikimet e dokumentacionit të administruar<sup>11</sup>, rezultoi se ajo është përfituar sipas kontratës së porosisë datë 4.5.2011 dhe kontratës përfundimtare të shitjes nr. \*\*\*, datë 10.9.2012.

**19.4** Në analizë të secilës kontratë, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar kontratën e porosisë në datën 4.5.2011 me shoqërinë “E” sh.p.k., për apartamentin e ndodhur në katin e 6-të, me sipërfaqe totale 116 m<sup>2</sup>, në vlerën 50.000 euro dhe në datën 10.9.2012 palët kanë nënshkruar kontratën e shitjes së pasurisë, me nr. \*\*\*, datë 10.9.2012. Çmimi i shitjes në kontratë është pasqyruar 6.800.000 lekë ose ekuivalenti i saj 50.000 euro. Në kontratë cilësohet se vlera e plotë e çmimit të shitjes është likuiduar totalisht jashtë zyrës noteriale.

**19.5** Në kartelën e regjistrimit të kësaj pasurie, përveç regjistrimit të sip. 106 m<sup>2</sup>, në rubrikën “përshkrim i veçantë” ishte pasqyruar edhe ballkoni me sip. 15,3 m<sup>2</sup>. I njëjti përshkrim u konstatua edhe në kartelën e kësaj pasurie, regjistruar më parë në emër të shitësit/shoqërisë ndërtimore “E” sh.p.k.

**19.6** Në planimetrinë e pasurisë së ndodhur në katin e 6-të, cilësohet se sipërfaqja e shfrytëzueshme është 106 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqja e përbashkët është 10 m<sup>2</sup>.

<sup>9</sup> Certifikatë për vërtetim pronësie nr. \*\*\*, datë 17.9.2012, për apartamentin me sip. 106 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, Vlorë, në pronësi të znj. Armida Moçka + kartelë pasurie; kontratë porosisë datë 4.5.2011, me palë shoqëria “E” sh.p.k. dhe Armida Moçka, për porositje apartamenti me sip. 116 m<sup>2</sup>, vlera 50.000 euro. Pjesa do të bëhet, kësti i parë me lidhjen e kontratës 50.000 euro; leje ndërtimi e miratuar me vendimin nr. \*\*\*, datë 23.10.2009, të KRRT-së, për banesë 9-10 kat, 2 kate dyqane, 1 kat parkim, lagjja “\*\*\*\*”, Vlorë, në emër të shoqërisë “E” sh.p.k.; kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 10.9.2012, me palë shitëse shoqëria “E” sh.p.k. dhe palë blerëse Armida Moçka, për blerje apartamenti me sip. 116 m<sup>2</sup>, vlera 6.800.000 lekë, e konvertuar në 50.000 euro, vlerë e likuiduar totalisht; certifikatë për vërtetim pronësie nr. \*\*\*, datë 13.4.2012, për apartament me sip. 106 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, Vlorë, në pronësi të shoqërisë “E” sh.p.k. + kartelë pasurie + praktikë e shoqërisë “E” sh.p.k. Aneks nr. \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>10</sup> Shihni dokumentin e administruar në aneksin \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>11</sup> Shihni dokumentacionin në dosjen e ILDKPKI-së/aneks \*\*\*, ku ZQRPP-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.9.2017, ka bashkëlidhur përgjigjen e ZVRPP-së Vlorë.

**19.7** Në analizë të të dhënave të përshkruara më sipër u vërejt mospërputhje midis sipërfaqes 106 m<sup>2</sup>, e regjistruar në certifikatën për vërtetim pronësie, dhe sipërfaqes 106 m<sup>2</sup> dhe 15,3 ballkoni, pasqyruar në kartelën bashkëshoqëruese të certifikatës.

**19.8** Subjekti është pyetur<sup>12</sup> në lidhje me këtë mospërputhje, e cila, në shpjegimet e saj, ndër të tjera, ka deklaruar se: “...*sipërfaqja e apartamentit me nr. pasurie \*\*\* është 106 m<sup>2</sup> së bashku me sipërfaqet prej 15,3 m<sup>2</sup> të ballkonit, bazuar në dokumentacionin e lejes së ndërtimit dhe planimetrive. Sipërfaqet e ballkonit janë brenda sipërfaqes së apartamentit. Ndodhur në këto kushte është gabim material vendosja e shënimit të ballkonit. Ky fakt vërtetohet nga shkresa kthim përgjigjeje e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë, datë 4.11.2022*”. Subjekti ka depozituar kopje të shkresës kthim përgjigjeje datë 4.11.2022, administruar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë, si dhe kartelën e pasurisë me korigjimin<sup>13</sup> përkatës të këtij gabimi material.

**a)** Nga verifikimi i informacionit të dhënë nga ASHK Drejtoria Vendore Vlorë, në datën 4.11.2022 (sipas aplikimit të bërë në sistemin *e-albania* shoqëruar me përgjigjen), kjo e fundit konfirmon se ka pasur një gabim material në plotësimin e kartelës së kësaj pasurie. ASHK Drejtoria Vendore Vlorë në përgjigjen e saj ka konfirmuar se sipërfaqja e ballkonit është pjesë përbërëse e të gjithë pasurisë prej 106 m<sup>2</sup>.

**b)** Lidhur me këtë mospërputhje, edhe shoqëria ndërtimore “E” sh.p.k.<sup>14</sup> ka informuar se *sipërfaqja e ballkonit që kadastra e ka vendosur tek përshkrimi i veçantë prej 15,3 m<sup>2</sup>, është e përfshirë në sipërfaqen 106 m<sup>2</sup> të apartamentit.*

**19.9** FSHU-ja<sup>15</sup> informon se me gjeneralitetet Armida LL. Hamiti nuk rezulton të jetë abonent dhe të ketë kontratë të furnizimit me energji elektrike. Subjektit i është kërkuar<sup>16</sup> të depozitohet kontratën për furnizimin me energji elektrike në lidhje me pasurinë objekt i këtij hetimi administrativ. Në përgjigje subjekti ka depozituar kërkesën për informacion<sup>17</sup> drejtuar FSHU-së dhe përgjigjen<sup>18</sup>, ku konfirmohet kartela e furnizimit me energji elektrike e cila i përket kontratës me nr. \*\*\*, me abonentin subjektin e rivlerësimit, hapur në datën 21.11.2011. FSHU-ja, gjithashtu, ka bashkëlidhur edhe praktikën përkatëse të kësaj kontrate, e cila provon të gjithë veprimet institucionale për lidhjen e kontratës me abonentin, nga ku nuk konstatohen problematika.

**19.10** UKT-ja<sup>19</sup> nuk ka konfirmuar kontratë shërbimi për subjektin e rivlerësimit dhe as për familjarët e saj. Subjekti është pyetur<sup>20</sup> dhe në përgjigje ka depozituar kontratën përkatëse për shërbime ujësjellësi, me nr. \*\*\*, datë 21.7.2011.

**19.11** Në lidhje me likuidimin e kësaj pasurie, Komisionit i ka rezultuar:

**19.11.i** Subjekti ka deklaruar se kjo pasuri është blerë në vlerën 50.000 euro. Në kontratën e porosisë së këtij apartamenti nuk është pasqyruar një kalendar pagesash në këste.

<sup>12</sup> Me pyetësin nr. 2, datë 28.10.2022, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>13</sup> Depozituar me pyetësin nr. 3, datë 10.11.2022.

<sup>14</sup> Në shkresën e saj datë 7.11.2022, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>15</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 13.8.2020.

<sup>16</sup> Me pyetësin nr. 2, datë 28.9.2022.

<sup>17</sup> Kërkesë datë 31.10.2022.

<sup>18</sup> Referohuni shkresës nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2022, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>19</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 4.11.2022, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>20</sup> Me pyetësin nr. 2, datë 28.10.2022.



**19.11.ii** Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar, konkretisht sipas *statement*-it bankar<sup>21</sup>, rezulton se nga llogaria bankare e subjektit të rivlerësimit në ABI Bank janë paguar 40.000 euro në favor të shoqërisë ndërtimore “E” sh.p.k., me katër transfertë bankare, sikurse pasqyrohet në tabelën si vijon:

**Tabela nr. 1**

Data	Shuma në euro	Përshkrimi i transaksionit
24.5.2011	10,000	Transfer E sh.p.k., pagesë për blerje apartamenti nga Armida Moçka
30.5.2011	10,000	Transfer E sh.p.k., pagesë për blerje apartamenti nga Armida Moçka
19.8.2011	10,000	Transfer E sh.p.k., likuidim këst apartamenti nga Armida Moçka
26.8.2011	10,000	Transfer E sh.p.k., pagesë për blerje apartamenti nga Armida Moçka

**19.11.iii** Subjekti është pyetur<sup>22</sup> në lidhje me pagesën e shumës 50.000 euro të shpenzuar për këtë pasuri, e cila, në përgjigje të saj ka deklaruar se: “*Shuma prej 50.000 euro për blerjen e apartamentit është paguar e ndarë në 5 (pesë) këste, të cilat janë paguar nga unë nëpërmjet sistemit bankar, dhe më konkretisht: 4 këste janë paguar nëpërmjet bankës NBG, sot ABI Bank, secili në shumën 10.000 euro, duke i kaluar nga llogaria ime në llogarinë e shoqërisë ‘E’ sh.p.k.; 1 këst është paguar prej meje depozitim cash në llogarinë e shoqërisë ‘E’ sh.p.k., në vlerën 10.000 euro. Bëj me dije gjithashtu se të gjitha pagesat e kësteve për blerjen e apartamentit janë kryer përpara emërimit tim në detyrë<sup>23</sup>, pra në kohën që nuk kam qenë subjekt në detyrë*”. Subjekti ka depozituar *statement* të nxjerrë nga NBG Bank, sot ABI Bank, ku evidentohen pagesat.

**19.11.iv** Komisioni<sup>24</sup> i ka kërkuar informacion dhe dokumentacion justifikues edhe shoqërisë ndërtimore “E” sh.p.k., lidhur me pagesat e kryera për këtë apartament, e cila ka informuar<sup>25</sup> se likuidimi i apartamentit është bërë totalisht me bankë pranë NBG Bank dhe për këtë informacion ka bashkëlidhur edhe *statement*-in bankar.

**19.11.v** Nga analizimi i *statement*-it të shoqërisë rezulton se vlera e pasurisë prej 50.000 euro është likuiduar totalisht nëpërmjet sistemit bankar. Më konkretisht, rezultoi se 4 këste (secili nga 10.000 euro) janë kryer me transfertë nga llogaria bankare e subjektit në atë të shoqërisë “E” sh.p.k., sipas kalendarit të pasqyruar në tabelën nr. 1 dhe një këst prej 10.000 euro është depozituar *cash* në datën 17.8.2011 nga subjekti i rivlerësimit në llogarinë e shoqërisë, me përshkrimin “pagesë për blerje apartamenti”.

**19.12** Trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të administruar, deklarimeve të subjektit, si dhe fakteve e rrethanave të konstatuara, vlerëson se subjekti ka deklaruar me vërtetësi dhe saktësi çmimin e kësaj pasurie.

**19.13** Në lidhje me ndonjë trajtim të mundshëm preferencial në blerjen e këtij apartamenti, Komisioni i është referuar udhëzimit nr. 4, datë 23.11.2011, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2011”. Sipas udhëzimit rezulton se

<sup>21</sup> Referohuni shkresës nr. \*\*\* prot., datë 28.7.2022, nga ABI Bank.

<sup>22</sup> Me pyetësin nr. 2, datë 28.10.2022.

<sup>23</sup> Dekret Nr.\*\*\*, datë 16.11.2011, “Për Emërim Prokurori në Stazh”.

<sup>24</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 1.11.2022, administruar në dosjen e hetimit administrativ.

<sup>25</sup> Me shkresën datë 7.11.2022.

vlera mesatare e shitblerjeve të banesave në tregun e lirë për vitin 2011, për qytetin e Vlorës, është 60.298 lekë/m<sup>2</sup>.

**19.13.i** Apartamenti i blerë nga subjekti i rivlerësimit është me sip. 116 m<sup>2</sup>. Duke u bazuar në çmimet referuese rezulton se vlera e apartamentit është 6.994.568 lekë. Kjo vlerë është 79.568 lekë më e lartë nga çmimi që ka paguar subjekti, pasi apartamenti është blerë në vlerën 6.915.000 lekë<sup>26</sup>, shumë e cila mund të merret me rezervë për shkak të kursit të këmbimit. Për këtë arsye subjektit i është kërkuar të depozitohet kontrata të ngjashme.

**19.13.ii** Subjekti ka depozituar: kontratën nr. \*\*\*, datë 28.6.2013, për blerje apartamenti, lidhur midis shoqërisë së ndërtimit “E” sh.p.k. dhe shtetasit A.M; si dhe kontratën nr. \*\*\*, datë 12.9.2013, për blerje apartamenti, lidhur midis shoqërisë së ndërtimit “E” sh.p.k. dhe shtetasve S.B dhe S.B.

**19.13.iii** Nga verifikimi i kontratave të depozituara rezulton se pasuritë e shitura konfirmohen në të njëjtin pallat, kontratat janë lidhur mes palëve thuajse në të njëjtën kohë që ka blerë subjekti këtë apartament dhe se çmimi i shitblerjes së tyre është i përafërt me shumën e investuar nga subjekti i rivlerësimit.

**19.14** Komisioni, pasi verifikoi kontratat e depozituara, në raport me shpjegimet e subjektit dhe dokumentacionin e administruar, konkludon se duket se nuk ekzistojnë kushtet e ndonjë trajtimi preferencial të mundshëm në blerjen e kësaj pasurie. Po ashtu arrihet në këtë konkluzion pasi diferenca në çmim jo vetëm që është e papërfillshme, por ajo mund të vijë edhe për shkak të kursit të këmbimit.

**19.15** Në lidhje me gjendjen e ndonjë konflikti të mundshëm interesi mes palëve në këtë shitblerje, për shkak të ushtrimit të funksionit të subjektit të rivlerësimit, kjo e fundit është pyetur<sup>27</sup> nëse ka hetuar, mosfilluar, pushuar apo dërguar për gjykim ndonjë çështje penale në ngarkim apo nisur nga shtetasi V.S.H si administrator i shoqërisë “E” sh.p.k., dhe në përgjigjen e dhënë ka deklaruar se në asnjë rast nuk ka kryer ndonjë veprim hetimor deri edhe në përfaqësimin në gjykim për këtë shoqëri apo administratorin e saj si individ.

**19.16** Subjekti i rivlerësimit, për të vërtetuar këtë fakt, ka depozituar dokumentacionin<sup>28</sup> mbështetës, ku rezulton se asnjë nga institucionet punëdhënëse nuk konfirmojnë ndjekje të materialeve kallëzuese apo procedime penale që kanë lidhje me shoqërinë “E” sh.p.k. apo administratorin e saj V.H.

**19.17** Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar dhe përgjigja e subjektit të rivlerësimit, duket se nuk konfirmohen të dhëna për të konkluduar në ndonjë konflikt të mundshëm interesi midis subjektit dhe administratorit të shoqërisë së ndërtimit.

---

<sup>26</sup> Sipas Bankës së Shqipërisë, kursi mesatar vjetor për vitin 2011. Në pamundësi për të përcaktuar kohën e saktë të këmbimit të shumave të cilat janë përdorur për likuidimin e kësaj pasurie, Komisioni i është referuar kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë.

<sup>27</sup> Me pyetësorin nr. 2, datë 28.10.2022.

<sup>28</sup> Kërkesë e datës 31.10.2022, me objekt “marrjen e informacionit”, drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, nr. \*\*\* prot., datë 31.10.2022, së bashku me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 1.11.2022, me lëndë “Kthim përgjigje, administruar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë”; kërkesë e datës 30.10.2022, me nr. \*\*\* prot., datë 1.11.2022, me objekt “Marrjen e informacionit”, drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, së bashku me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 3.11.2022, me lëndë “Kthim përgjigje”, të kësaj prokurorie.

## 19.18 Në lidhje me burimin e krijimit të shumës së investuar në këtë pasuri

**19.18.i** Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se kjo pasuri është blerë me të ardhura të siguruara nga aktiviteti i familjes bujqësore prej vitit 1994 deri në vitin 2011.

**19.18.ii** Pavarësisht se kjo pasuri është porositur dhe likuiduar brenda të njëjtit vit kalendarik deri në gusht të vitit 2011, pra përpara emërimit në detyrë<sup>29</sup> të subjektit të rivlerësimit dhe faktit se ajo nuk ka kontribut në të, Komisioni hetoi lidhur me burimin e krijimit. Komisioni i kërkoi<sup>30</sup> subjektit të depozitohë dokumentacionin justifikues për të provuar ligjshmërinë e të ardhurave nga aktiviteti bujqësor i familjes prej vitit 1994 deri në vitin 2011, të cilat kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie, si dhe të sqarojë mënyrën e mbajtjes, administrimit dhe shpërndarjes së këtyre të ardhurave.

**19.18.iii** Në përgjigjen e dhënë subjekti ka deklaruar se shuma 50.000 euro, e cila ka shërbyer për blerjen e apartamentit të banimit, me sip. 106 m<sup>2</sup> (plus 10 m<sup>2</sup> sipërfaqe e përbashkët), në Vlorë, e ka burimin nga të ardhurat e krijuara nga aktiviteti privat bujqësor dhe blegtoral i familjes me kryefamiljar shtetasin LL.K.M, nga viti 1994 deri në vitin 2011 dhe për të provuar këtë fakt ka depozituar dokumentacionin përkatës<sup>31</sup>.

<sup>29</sup> Datë 16.11.2011, dekretuar në periudhë stazhi.

<sup>30</sup> Me pyetësorin nr. 2, datë 28.10.2022.

<sup>31</sup> Një kopje të Aktit të Marrjes së Tokës në Përdorim me nr. regj. akti \*\*\*, datë 11.10.1994, me sip. 5.000 m<sup>2</sup> (në bashkëpronësi me familjen bujqësore, të përbërë nga 5 anëtarë), i paregjistruar në regjistrat publikë, e ndodhur në fshatin A, Bashkia Vlorë; një kopje e Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi me nr. \*\*\*, datë 6.3.1993, prej së cilës janë regjistruar në regjistrat publikë ngastrat e poshtëshënuara; një kopje e certifikatës për vërtetim pronësie, tipi i pasurisë arë, data e regjistrimit 16.7.2018, nr. i pasurisë \*\*\*; një kopje e certifikatës për vërtetim pronësie, tipi i pasurisë arë, data e regjistrimit 16.7.2018, nr. i pasurisë \*\*\*; një kopje e certifikatës për vërtetim pronësie, tipi i pasurisë arë, data e regjistrimit 5.7.2022, nr. i pasurisë \*\*\*; një kopje e certifikatës për vërtetim pronësie, tipi i pasurisë arë, data e regjistrimit 4.3.2016, nr. i pasurisë \*\*\*; një kopje e certifikatës për vërtetim pronësie, tipi i pasurisë arë, data e regjistrimit 8.7.2019, nr. i pasurisë \*\*\*; një kopje e vërtetimit për të vetëpunësuar në bujqësi në emër të shtetasit L.XH.M, lëshuar nga ISSH-ja Vlorë; një kopje e librezës së kontributeve të sigurimeve shoqërore të derdhura në emër të shtetasit L.XH.M; një kopje e vërtetimit nr. \*\*\* prot., datë 23.6.2020, lëshuar nga Njësia Administrative N, Drejtoria e Tatim-Taksave, nga e cila rezulton se fermeri LL.K.M nuk ka detyrime për tokën bujqësore; një kopje e vërtetimit nr. \*\*\* prot., datë 12.6.2020, lëshuar nga Njësia Administrative N, Bashkia Vlorë, me të cilin provohet fakti se fermeri LL.K.M ka në pronësi 270 rrënjë ullinj; një kopje e vërtetimit nr. \*\*\* prot., datë 1.7.2020, lëshuar nga Njësia Administrative N, Bashkia Vlorë, me të cilin provohet fakti se fermeri LL.K.M tokën që ka në pronësi dhe përdorim e ka punuar gjithë kohës dhe ka paguar rregullisht detyrimet për tokën; një kopje e vërtetimit datë 1.9.2020, lëshuar nga Kryesia e Fshatit M, Njësia Administrative N, Bashkia Vlorë, me të cilën provohet se fermeri LL.K.M ka në pronësi 270 rrënjë ullinj; një kopje e certifikatës së regjistrimit të fermerit LL.K.M; një kopje e të dhënave të printuara nga sistemi Ruda – Sistemi i Informacionit Blegtoral dhe Veterinar, pranë Drejtorisë Rajonale Veterinare dhe Mbrojtjes së Bimëve Vlorë, me të cilin provohet se fermeri LL.K.M është marrë me veprimtarinë e \*\*\*; një kopje e shkresës nr. \*\*\* prot., datë 23.7.2020, me lëndë “informacion”, drejtuar shtetasit LL.M, lëshuar nga Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Bashkia Vlorë, mbi vlerësimin e prodhimit mesatar për kultivarin \*\*\* dhe kultivarin \*\*\*; një kopje e vërtetimit nr. \*\*\* prot., datë 10.7.2020, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve Vlorë, me të cilin vërtetohet se për periudhën 1993 – 2010 nuk rezulton të ketë regjistër për numrin e krerëve të gjedhëve të familjeve bujqësore. Ky regjistër në Qarkun e Vlorës ka filluar të funksionojë pas vitit 2011; një kopje e vërtetimit nr. \*\*\* prot., datë 1.7.2020, mbi numrin e ullinjve që ka në pronësi fermeri LL.K.M; një kopje e dokumentit deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 13.8.2020, lëshuar nga shtetasi S.P, me profesion veterinar, me të cilën provohet fakti se në cilësinë e mjekut veterinar ka ofruar shërbimin veterinar për katër krerë lopë qumështi të racës kryqëzim laramane, vijaç e tyre deri në moshën 1 vjeç, si dhe rreth 60 – 70 krerë shpendë fushe dhe deti të fermerit LL.K.M, banor i fshatit M, Njësia Administrative N, gjatë periudhës 1993 – 2011; një kopje e dokumentit deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 18.8.2020, lëshuar nga shtetasi V.M, me të cilën provohet fakti se në cilësinë e administratorit të shoqërisë “M. O. O.” sh.p.k. deklaroi se fermeri LL.K.M, banor i fshatit M, Njësia Administrative N, ka shitur dhe përpunuar pranë fabrikës së tij sasi të shumta ulliri prej vitit 1995 e në vazhdim; një kopje e të dhënave të QKB-së mbi regjistrimin e këtij subjekti; një kopje e dokumentit deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 13.8.2020, lëshuar nga shtetasi A.B, me të cilën provohet fakti se me cilësinë e personit që ka ushtruar zanatin e \*\*\*, deklaroi se ka blerë nga fermeri LL.K.M, banor i fshatit M, Njësia Administrative N, vijaç në moshën 1-vjeçare dhe gjela deti; një kopje e të dhënave të QKB-së mbi regjistrimin e këtij subjekti; një kopje e dokumentit deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 25.8.2020, lëshuar nga shtetasi DH.G, me të cilën provohet fakti se fermeri LL.K.M, banor i fshatit M, Njësia Administrative N, ka shitur pranë fabrikës së tij sasi të shumta qumështi nga viti 1995 deri në vitin 2011; një kopje e deklaratës noteriale të shtetasit L.N nr. \*\*\*, datë 2.11.2022, me të cilën provohet fakti që të ardhurat që

**19.18.iv** Nga dokumentacioni i administruar, konkretisht (a) nga AMTP-të e trajtuara në pasuritë e sipërdeklaruar nga subjekti; (b) pesë certifikatat për vërtetim pronësie regjistruar në emër të kryefamiljarit të familjes bujqësore; (c) konfirmimi se fermeri LL.M, babai i subjektit, së bashku me familjen e tij kanë qenë me vendbanim të përhershëm në fshatin M, Njësia Administrative N, Vlorë, ku kryesisht zotërohet pjesa më e madhe e tokës në pronësi; (ç) konfirmimi i Njesisë Administrative N<sup>32</sup> mbi pronësinë e tokës bujqësore, si dhe të sipërfaqes në përdorim prej familjes bujqësore që prej vitit 1993 e në vazhdim; (d) konfirmimi i pagesës së rregullt për taksën e tokës bujqësore; (dh) nga vërtetimi i lëshuar nga Drejtoria e Tatim-Taksave pranë kësaj Njësie Administrative, ku konfirmohet që fermeri LL.M<sup>33</sup> nuk ka detyrime për tokën bujqësore; (e) nga konfirmimi se shtetasi LL.M ka në pronësi të tij \*\*\* rrënjë ullinj në këtë fshat, nga të cilat \*\*\* rrënjë të llojit kalinjot, ndërsa \*\*\* rrënjë të llojit frantoil, janë shtuar më pas dhe futur në prodhim prej vitit 1996; (ë) fotot e ullishtave të depozituara nga subjekti, ku duket të jenë në administrim sipërfaqe të konsiderueshme me rrënjë të ullinjve, pemëtore, etj. – Komisioni konstaton se identifikohen të dhëna se pasuritë e familjes bujqësore kanë shërbyer për zhvillimin e aktivitetit bujqësor me qëllim gjenerimin e të ardhurave në favor të saj.

**19.18.v** Vendbanimi i përhershëm i kësaj familjeje bujqësore në fshatin M konfirmohet gjithashtu edhe prej kontratës së energjisë elektrike. FSHU-ja<sup>34</sup> konfirmoi dy kontrata të furnizimit me energji elektrike me abonent shtetasin LL.M, përkatësisht kontrata me nr. \*\*, hapur në datën 28.12.2008, në kategorinë “familjar”, me adresë \*\* - Vlorë dhe nr. \*\*, hapur në datën 7.7.2004, në kategorinë “familjar”, me adresë \*\* - Vlorë<sup>35</sup>. Në lidhje me ekzistencën e këtyre dy kontratave, Komisioni aksesoi regjistrin e gjendjes civile, nga ku rezultoi se në territor vendi identifikohen dy persona me emrin LL.M, porse kontrata e shërbimit nr. \*\*, që pasqyron adresën \*\* – Vlorë, i përket shtetasit LL.K.M (babai i subjektit të rivlerësimit), ndërsa kontrata tjetër nr. \*\*, që pasqyron adresën \*\* - Vlorë, i përket shtetasit LL.K.M.

---

fitonte gjatë nga aktiviteti privat bujqësor babai i këmbente me monedhën euro pranë pikës së këmbimit valutor “A” *exchange*; një kopje e faturave të lëshuara nga “A” *exchange* mbi këmbimet e monedhave që janë kryer ndër vite nga babai pranë kësaj pike këmbimi valutor; një kopje e dosjes së pensionit të babait LL.K.M, 40 faqe; një kopje e certifikatës së përbërjes familjare të datës 1.8.1991; një kopje e shkresës nr. \*\* prot., datë 1.11.2022, me të cilën kërkohet informacion i shoqëruar me akte pranë Njesisë Administrative N; një kopje e shkresës nr. \*\* prot., datë 2.11.2022, me të cilën është dërguar raporti i vlerësimit ekonomiko-bujqësor, mbi të ardhurat dhe fitimin e krijuar nga aktiviteti bujqësor dhe blegtoral i familjes së shtetasit LL.K.M gjatë periudhës 1993 – 2016, i hartuar nga agronomi, veterineri dhe administratori i Njesisë Administrative N pranë Bashkisë Vlorë, 6 faqe; fotografi të ullinjve; mandatarkëtimi nr. \*\*, datë 15.2.2011; mandatarkëtimi nr. \*\*, datë 20.5.2011; mandatarkëtimi nr. \*\*, datë 14.5.2012; mandatarkëtimi nr. \*\*, datë 12.1.2012; mandatarkëtimi nr. \*\*, datë 23.7.2013; fletë - dalje datë 20.3.2005; fletë - dalje datë 13.2.2006; fletë - dalje datë 7.1.2007; fletë - dalje datë 10.3.2008; fletë - dalje datë 15.9.2008; fletë - dalje datë 22.2.2009; fletë - dalje datë 9.10.2009; fletë - dalje datë 8.2.2010; fletë - dalje datë 24.7.2010; fletë regjistri për kulturën grurë, viti 1998 - 1999; fletë regjistri për kulturën misër, viti 1998 - 1999; fletë regjistri për kulturën jonxhë, viti 1998 - 1999; fletë regjistri për kulturën ullinj, viti 1998 - 1999; fletë regjistri për kulturën misër, viti 2000 - 2001; fletë regjistri për kulturën grurë viti 2000 - 2001; fletë regjistri për kulturën jonxhë, viti 2000 - 2001; fletë regjistri për kulturën ullinj, viti 2000 - 2001; fletë regjistri për kulturën grurë, viti 2002 - 2003; fletë regjistri për kulturën jonxhë, viti 2002 - 2003; fletë regjistri për kulturën ullinj, viti 2002 - 2003; fletë regjistri për kulturën misër, viti 2002 - 2003; mandatarkëtimi nr. \*\*, datë 21.11.2013; mandatarkëtimi nr. \*\*, datë 6.11.2017; mandatarkëtimi nr. \*\*, datë 14.11.2018; mandatarkëtimi nr. \*\*, datë 17.11.2019; mandatarkëtimi nr. \*\*, datë 11.12.2021; mandatarkëtimi nr. 99, datë 4.11.2020; mandatpagesë datë 23.12.2006; mandatpagesë datë 3.11.2006; mandatpagesë datë 24.11.2007; mandatpagesë datë 29.10.2008; mandatpagesë datë 11.11.2008; mandatpagesë datë 20.12.2009; mandatpagesë datë 1.11.2010; mandatpagesë datë 6.11.2012; mandatpagesë datë 9.10.2013; mandatpagesë datë 11.11.2013; mandatpagesë datë 9.11.2016.

<sup>32</sup> Vërtetim nr. \*\* prot., datë 1.7.2020, depozituar me pyetësin nr. 2, datë 28.10.2022.

<sup>33</sup> Regjistruar sipas certifikatës së regjistrimit të fermerit, akt i depozituar nga subjekti i rivlerësimit me pyetësin nr. 2, datë 28.10.2022.

<sup>34</sup> Shkresë nr. \*\* prot., datë 13.8.2020.

<sup>35</sup> Kjo adresë përkon me vendbanimin e prindërve të subjektit, sikurse ka vërtetuar edhe Njësia Administrative N me vërtetimin datë 20.10.2016 (administruar në dosjen e ILDKPKI-së, aneks nr. 4/5) se shtetasi LL.K.M është banor i fshatit M.

**19.18.vi** Në analizë të dokumentacionit të administruar, lidhur me ushtrimin e aktivitetit bujqësor dhe mundësinë e krijimit të të ardhurave, Komisioni ka konstatuar se:

- a) Nëna e subjektit të rivlerësimit L.XH.M ka qenë e vetëpunësuar në bujqësi dhe ka derdhur rregullisht<sup>36</sup> kontributet e sigurimeve shoqërore për vitet 1993 – 2022.
- b) Babai i subjektit ka qenë i punësuar në institucione shtetërore<sup>37</sup> për vitet 1993 – 2016.
- c) Babai i subjektit ka qenë i regjistruar në sistemin Ruda<sup>38</sup>, sistem i Informacionit Blegtoral dhe Veterinar pranë Drejtorisë Rajonale Veterinare dhe Mbrojtjes së Bimëve Vlorë, me të cilin provohet se fermeri LL.K.M është marrë me veprimtarinë e mbarështimit të gjedhëve. Sipas regjistrimit të fermës rezulton se ky shtetas disponon \*\*\* gjedhë dhe \*\*\* shpendë.
- d) Drejtoria Rajonale e Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve Vlorë<sup>39</sup> informon se për periudhën 1993 – 2010 nuk rezulton të ketë regjistër për numrin e krerëve të gjedhëve të familjeve bujqësore dhe se ky regjistër në Qarkun e Vlorës ka filluar të funksionoj pas vitit 2011.
- e) Raporti i Vlerësimit Ekonomiko - Bujqësor, i hartuar nga agronomi dhe veterineri i Njësisë Administrative N, Bashkia Vlorë<sup>40</sup>, ka përcaktuar të ardhurat, fitimin *neto*, si dhe shpenzimet për rritjen dhe mirëmbajtjen e ullirit, kostot vjetore për prodhimet bujqësore, blegtorale dhe shpendarisë (pesticide, plehërim, punim toke, vaksinim, etj.) për periudhën 1993 – 2016.
- f) Nga dokumentacioni i depozituar pasqyrohet vlerësimi i prodhimit mesatar për kultivarin kalinjot dhe kultivarin frantoil<sup>41</sup>.

**19.18.vii** Gjithashtu, për të provuar aktivitetin bujqësor, subjekti ka depozituar:

- a) Deklaratë noteriale<sup>42</sup> të shtetasit S.P, me profesion veteriner, i cili deklaron se prej vitit 1993 deri në vitin 2011 ka ofruar shërbimin veterinar për \*\*\* krerë lopë qumështi të racës kryqëzim laramane, viçat e tyre deri në moshën 1-vjeçare, si dhe rreth \*\*\* krerë shpendë fushe dhe deti të familjes bujqësore të fermerit LL.K.M, banor i fshatit M, Njësia Administrative N.
- b) Deklaratë noteriale<sup>43</sup> të shtetasit V.M, në cilësinë e administratorit të shoqërisë “M. O. O.” sh.p.k., i cili deklaron se fermeri LL.K.M, banor i fshatit M, Njësia Administrative N, ka shitur dhe përpunuar pranë fabrikës së tij sasi të shumta ulliri prej vitit 1995 e në vazhdim.

<sup>36</sup> Sipas librezës së kontributeve dhe vërtetimit për të vetëpunësuarit në bujqësi nga ISSH, Drejtoria Rajonale Vlorë, depozituar nga subjekti në pyetësin nr. 2, datë 28.10.2022.

<sup>37</sup> DRSSH Vlorë, ka përcjellë vërtetim për bazën e vlerësueshme 1993 – 2003; OSHEE, vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare (1 janar – 31 maj 2004); Ujësllës N, vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare (maj 2004 – 2012), depozituar me pyetësin nr. 2, datë 28.10.2022, si dhe shkresë nr. \*\*\* prot., datë 25.8.2020, e BKT-së, në dosjen e hetimit të Komisionit.

<sup>38</sup> Sipas kopjes së printuar nga sistemi Ruda, depozituar nga subjekti me pyetësin nr. 2, datë 28.10.2022.

<sup>39</sup> Referohuni vërtetimit nr. \*\*\* prot., datë 10.7.2020.

<sup>40</sup> Referohuni shkresës nr. \*\*\* prot., datë 1.11.2022 (me të cilën kërkohet nga subjekti i rivlerësimit informacion i shoqëruar me akte pranë Njësisë Administrative N), shkresës nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2022, si dhe raportit përkatës, depozituar nga subjekti i rivlerësimit.

<sup>41</sup> Referohuni shkresës nr. \*\*\* prot., datë 23.7.2020, me lëndë “Informacion”, drejtuar shtetasit LL.M, lëshuar nga Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Bashkia Vlorë.

<sup>42</sup> Referohuni kopjes së deklaratës noteriale nr. \*\*\*, datë 13.8.2020, depozituar nga subjekti i rivlerësimit.

<sup>43</sup> Referohuni deklaratës noteriale nr. \*\*\*, datë 18.8.2020 dhe kopjes së të dhënave të QKB-së mbi regjistrimin e këtij subjekti, depozituar nga subjekti i rivlerësimit.

- c) Deklaratë noteriale<sup>44</sup> të shtetasit A.B, me cilësinë e personit që ka ushtruar profesionin e kasapit prej vitit 2000, i cili deklaron se ka blerë nga fermeri LL.K.M, banor i fshatit M, Njësia Administrative N, viça në moshën 1-vjecare dhe gjela deti.
- d) Deklaratë noteriale<sup>45</sup> të shtetasit DH.G, i cili deklaron se është marrë me përpunimin e qumështit që prej vitit 1992 deri në 2011-ën. Ai deklaron se në cilësinë e personit fizik ka ushtruar veprimtarinë tregtare në fushën e përpunimit të qumështit dhe se fermeri LL.K.M, banor i fshatit M, Njësia Administrative N, ka shitur pranë fabrikës së tij sasi të shumta qumështi nga lopët e tij prej vitit 1995 deri në 2011-ën.
- e) Mandatarkëtime, fletë daljeje, si dhe fletë të regjistrimit<sup>46</sup> për kultura të ndryshme, ullinj, grurë, misër, jonxhe, të cilat pasqyrojnë blerje produktesh (pesticide, ure, nitrat, etj.) pra shpenzimet e kryera për mirëmbajtjen e kulturave bujqësore, si dhe mandatpagesa për të provuar shitjet e prodhimit të realizuar.

**19.18.viii** Subjekti, në përgjigjen e saj në vijim, ka deklaruar se kopjet e mandateve të depozituara të cilat përfaqësojnë zëra të të ardhurave dhe shpenzimeve, ia ka vendosur në dispozicion babai, duke sqaruar se sikurse ai i ka konfirmuar, nuk i ka ruajtur të gjitha dhe se ato që ka depozituar janë shumë pak në krahasim me gjithë veprimtarinë e aktivitetit privat bujqësor dhe blegtoral të ushtruar prej vitit 1994 e deri aktualisht. Subjekti ka theksuar se babai i saj nuk është subjekt deklarues, ashtu siç nuk ka qenë edhe ajo në kohën kur janë krijuar të ardhurat, të cilat i ka deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës.

**20. Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* të ardhura nga aktiviteti privat familjar bujqësor vreshtari, ullishtë, bujqësi, shpendari dhe blegtori** (në bashkëpronësi të familjes bujqësore të përbërë nga 5 anëtarë) të krijuara prej vitit 1994 deri në vitin 2011 në vlerën 53.000 euro, duke sqaruar se kjo vlerë është depozituar në bankat e nivelit të dytë shuma 50.000 euro, ndërsa në datën 3.12.2015 kontratat e depozitave janë mbyllur dhe transferuar në emër të prindit. Pjesa takuese: 20%. Për këtë deklaramin subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente<sup>47</sup>.

## Hetimi i Komisionit

**20.1** Subjekti i rivlerësimit i deklaroi për herë të parë këto të ardhura në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës, të dorëzuar në datën 14.12.2011, me përshkrimin “Të ardhura nga aktivitet privat i familjes bujqësore, ullishtë, vreshtari, bujqësi. Vlera: 53.000 euro”.

<sup>44</sup> Referohuni deklaratës noteriale nr. \*\*\*, datë 13.08.2020 dhe kopjes së të dhënave të QKB-së mbi regjistrimin e këtij subjekti, depozituar nga subjekti i rivlerësimit.

<sup>45</sup> Referohuni deklaratës noteriale \*\*\*, datë 25.8.2020, depozituar nga subjekti i rivlerësimit.

<sup>46</sup> Referohuni akteve të cituara, depozituar nga subjekti i rivlerësimit.

<sup>47</sup> Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 13.10.2016, i Njesisë Administrative N, Bashkia Vlorë, me të cilin vërtetohet se subjekti LL.M, fshati A, ka shlyer të gjitha detyrimet tatimore pranë Njesisë Administrative N deri në vitin 2016, me nr. akti \*\*\* dhe sip. 5.000 m<sup>2</sup>; vërtetim datë 20.10.2016, i Njesisë Administrative N, Bashkia Vlorë, me të cilin vërtetohet se shtetasi LL.M është banor i fshatit M dhe në zbatim të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, ka përfutur në këtë fshat tokë arë me sip. 18.619 m<sup>2</sup>, po kështu si ish-banor i NB A ka përfutur tokë arë në përdorim me sip. 5.000 m<sup>2</sup>. Toka bujqësore është punuar dhe mbjellë rregullisht për çdo vit bujqësor. Janë mbjellë kultura bujqësore e blegtorale për nevoja familjare, si dhe ushqim për bagëti, shpend deti e fushe. Gjatë viteve ka zgjeruar sipërfaqen e mbjellë me ullishtë nga 3.000 m<sup>2</sup> në 8.000 m<sup>2</sup>. Me ndërtimin e autostradës Levan-Vlorë nga shpronësimi i sipërfaqes për investim publik janë zbritur 444 m<sup>2</sup>; vërtetim nga kryetari i fshatit M, me të cilin vërtetohet se shtetasi LL.M është banor i fshatit M dhe në zbatim të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, ka përfutur në këtë fshat tokë arë me sip. 18.619 m<sup>2</sup>, po kështu si ish-banor i NB A ka përfutur tokë arë në përdorim me sip. 5.000 m<sup>2</sup>. Gjatë gjithë kohës fermeri LL.M ka punuar tokën dhe është marrë me prodhimin e ullinjve, të vreshtës, mbarështrim të gjedhit, rritjen e shpendëve të detit dhe pulave të fushës, ka shtuar sipërfaqen e mbjellë me ullishtë nga 3.000 m<sup>2</sup> në 8.000 m<sup>2</sup>, është marrë edhe me prodhimin e drithërave të bukës. Aneks nr.\*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.

**20.2** Siç u trajtua edhe më sipër, subjekti i rivlerësimit në deklaratën e parë para fillimit të detyrës ka deklaruar blerjen e apartamentit në vlerën 50.000 euro dhe të ardhurat e familjes së saj prej 53.000 euro, me burim krijimi nga aktiviteti privat i familjes bujqësore.

**20.3** Sa i përket aktivitetit privat të familjes bujqësore, Komisioni ka pasqyruar faktet, rrethanat dhe provat e depozituara më sipër në këtë vendimmarrje, ndërsa arsyetimi mbi mundësinë e krijimit të kësaj shume është vlerësuar të arsyetohet në tërësi për shkak se pasuritë e deklaruara nga subjekti, si apartamenti objekt hetimi, kjo shumë e depozituar në bankë, si dhe shuma 3.000 euro e përdorur për blerjen e garazhit, i cili trajtohet në vijim, janë deklaruar nga subjekti të krijuara me të njëjtin burim/të ardhura nga aktiviteti bujqësor dhe blegtoral dhe po ashtu të siguruara në të njëjtën periudhë përpara fillimit të detyrës prej saj, në vitet 1994 – 2011.

**21. Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* të ardhura të përfituara nga depozitat bankare të shumës 50.000 euro**, duke filluar prej datës 5.8.2011 deri në datën 3.12.2015 (data e mbylljes së depozitave), përkatësisht me kontratën e depozitës datë 5.8.2011 pranë NBG Bank në shumën 10.000 euro, kontratën e depozitës datë 1.12.2011 pranë NBG Bank në shumën 10.000 euro, kontratën e depozitës datë 7.11.2011, pranë “Intesa Sanpaolo Bank” në shumën 10.000 euro dhe kontratën e depozitës datë 3.8.2012, pranë “Tirana Bank” në shumën 20.000 euro. Totali i të ardhurave 60.633,733 lekë dhe 3.063,52 euro. Pjesa takuese: 20%.

**21.1** Subjekti, në deklaratën *Vetting*, krahas deklarimit më sipër, ka sqaruar se *depozitat e mësipërme në shumën 40.000 euro të depozituara pranë NBG Bank dhe “Tirana Bank”, së bashku me interesat e krijuara, janë mbyllur dhe transferuar tek “Intesa Sanpaolo Bank”. Për këtë shumë të transferuar është lidhur kontrata e depozitës datë 31.7.2015, ndërsa në datën 3.12.2015 është bërë mbyllja dhe transferimi i interesave të përfituara nga këto depozita bankare, së bashku me shumën 50.000 euro në emër të prindit.* Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente<sup>48</sup>.

## **Hetimi i Komisionit**

**21.2** Nga hetimi rezultoi se subjekti i rivlerësimit në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës (data e emërimit në detyrë 16.11.2011) dhe në atë periodike vjetore të vitit 2011 ka deklaruar në rubrikën “Angazhime dhe veprimtari private dhe/ose publike dhe të ardhurat e krijuara prej tyre”, të ardhura nga aktiviteti privat i familjes bujqësore, ullishtë, vreshtari, bujqësi, në vlerën 53.000 euro.

**21.3** Ndërsa, në deklaratat periodike vjetore të viteve 2012 - 2015, subjekti ka deklaruar interesat e përfituara nga depozitat për çdo vit dhe veprimet e kryera në vitin 2015 për mbylljen e depozitave, si dhe transferimin e tyre në “Intesa Sanpaolo Bank” në emër të nënës së saj.

---

<sup>48</sup> Marrëveshje depozite midis NBG Bank dhe znj. Armida Moçka, datë 5.8.2011, për depozitë në vlerën 10.000 euro; kontratë depozite midis NBG Bank dhe znj. Armida Moçka, datë 1.12.2011, për depozitë në vlerën 10.000 euro; kontratë depozite datë 7.11.2011, midis “Intesa Sanpaolo Bank” dhe znj. Armida Moçka, shuma 10.000 euro, afati 12 muaj; certifikatë depozite “Tirana Bank”, për depozitë në emër të znj. Armida Moçka, në vlerën 20.000 euro, interesi i përfituar 92.71 euro; vërtetim datë 24.2.2016, “Tirana Bank”, me të cilin vërtetohet se znj. Armida Moçka ka pasur depozitë me afat gjatë viti 2015, shuma ka qenë në vlerën 21.135 euro dhe nuk ka pasur të ardhura gjatë viti 2015. Depozita është mbyllur para afatit në datën 3.7.2015 dhe është transferuar në bankë tjetër në datën 7.7.2015; vërtetim nga NBG Bank, datë 25.2.2016, ku vërtetohet se znj. Armida Moçka ka përfituar interesa nga depozitat e mbyllura në datën 6.7.2015, në shumën totale 33.05 euro; kontratë depozite datë 31.7.2015 midis “Intesa Sanpaolo Bank” dhe znj. Armida Moçka, shuma 42.705 euro, afati 12 muaj; vërtetim datë 4.3.2016 “Intesa Sanpaolo Bank”, sipas të cilit znj. Armida Moçka ka pasur gjatë vitit 2015 dy depozita, përkatësisht në shumën 10.651 euro, e mbyllur në datën 3.12.2015, interesi i përfituar 9.020 lekë, ndërsa për depozitën në shumën 42.705 euro, çelur në datën 31.7.2015 dhe mbyllur në datën 3.12.2015, nuk ka përfituar interes. Aneks nr. \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.

**21.4** Nga korrespondenca e Komisionit me bankat e nivelit të dytë<sup>49</sup> rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka investuar shumën 50.000 euro në depozita, përkatësisht në ABI Bank (ish-NBG), “Tirana Bank” dhe “Intesa Sanpaolo Bank”.

**21.5** Pas analizimit të *statement*-it në secilën bankë rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer transaksionet e mëposhtme për çeljen e depozitave në bankat përkatëse.

**21.6** Rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka depozituar në ABI Bank shumën 10.000 euro në datën 5.8.2011, e cila është investuar në depozitë në datën 8.11.2011. Vërehet se për çdo vit kjo depozitë është maturuar dhe riçelur deri në vitin 2015.

**21.7** Gjithashtu, subjekti ka depozituar në po këtë bankë shumën 10.000 euro në datën 30.11.2011, e cila është investuar në depozitë në datën 1.12.2011. Vërehet se për çdo vit kjo depozitë është maturuar dhe riçelur deri në vitin 2015.

**21.8** Po ashtu rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka depozituar në “Intesa Sanpaolo Bank” shumën 10.000 euro në datën 7.11.2011 dhe në po të njëjtën datë kjo shumë është investuar në depozitë. Vërehet se për çdo vit kjo depozitë është maturuar dhe riçelur deri në vitin 2015.

**21.9** Më tej, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në datën 3.8.2012 në “Tirana Bank” shumën 20.000 euro, me përshkrimin “të ardhura nga aktiviteti privat bujqësor” dhe në po të njëjtën datë shuma është investuar në depozitë. Vërehet se për çdo vit kjo depozitë është maturuar dhe riçelur deri në vitin 2015.

**21.10** Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur gjendjet në fund të çdo viti për depozitat në secilën bankë.

**Tabela nr. 2**

Banka	Monedha	Viti 2011	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014
ABI Bank (2 depozita)	Euro	20,000.00	20,642.81	21,265.82	21,685.73
Intesa Sanpaolo Bank	Euro	10,000.00	10,243.37	10,482.77	10,633.43
Tirana Bank	Euro		20,000.00	20,725.00	21,135.00
	<b>TOTAL</b>	<b>30,000.00</b>	<b>50,886.18</b>	<b>52,473.59</b>	<b>53,454.16</b>

**21.11** Nga verifikimi përkatës rezultoi se për çdo vit subjekti i rivlerësimit ka përfituar interesa nga këto depozita, të cilat rezultojnë në vlerat si vijon:

**Tabela nr. 3**

Banka	Interesi i përfituar për vitin 2012 në euro	Interesi i përfituar për vitin 2013 në euro	Interesi i përfituar për vitin 2014 në euro	Interesi i përfituar për vitin 2015 në euro	TOTAL
ABI Bank (2 depozita)	642.81	623.01	419.91	41.14	<b>1,726.87</b>

<sup>49</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.7.2022, nga ABIBank; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 10.8.2020, nga “Tirana Bank”; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.8.2020, nga “Intesa Sanpaolo Bank”.



Intesa Sanpaolo Bank	243.37	239.40	150.66	18.17	<b>651.60</b>
Tirana Bank	92.71	632.71	410.20		<b>1,135.62</b>
<b>TOTAL</b>	<b>978.89</b>	<b>1,495.12</b>	<b>980.77</b>	<b>59.31</b>	<b>3,514.09</b>

**21.12** Në vitin 2015 veprimet që janë kryer me depozitat janë detajuar si vijon:

**21.12.i** Dy depozitat së bashku në ABI Bank pas maturimit dhe interesave të përfituara për çdo vit kanë arritur vlerën 21.726,87 euro në datën 6.7.2015 dhe po në këtë datë shuma 21.710 euro është transferuar në llogarinë e subjektit në “Intesa Sanpaolo Bank”.

**21.12.ii** Depozita në “Tirana Bank” pas maturimit dhe interesave të përfituara për çdo vit ka arritur vlerën 21.135 euro në datën 3.7.2015 dhe në datën 7.7.2015 kjo shumë është transferuar në llogarinë e subjektit në “Intesa Sanpaolo Bank”.

**21.12.iii** Depozita në “Intesa Sanpaolo Bank” pas maturimit dhe interesave të përfituara për çdo vit ka arritur vlerën 10.651,30 euro në datën 9.11.2015. Kjo shumë (10.651,30 euro) në datën 3.12.2015, së bashku me totalin e depozitave të mbërritura në “Intesa Sanpaolo Bank” nga transfertat e kryera nga ABI Bank dhe “Tirana Bank”, pas komisioneve bankare përkatëse të secilës bankë, është transferuar në llogarinë bankare të nënës së subjektit të rivlerësimit, shtetases L.M, për të hapur një depozitë re. Shuma e transferuar si rezultat i akumulimit të të gjitha depozitave dhe interesave bankare ka qenë 53.356,84 euro.

**21.13** Nga hetimi rezulton se nëna e subjektit ka çelur në datën 3.12.2015 depozitë në “Intesa Sanpaolo Bank” në shumën 53.356,84 euro, të cilën e disponon sipas korrespondencave të Komisionit deri në gusht të vitit 2020.

**21.14** Për sa më sipër, vërehet se të gjitha të ardhurat e deklaruara në deklaratën para fillimit të detyrës, me burim krijimi të ardhura familjare nga aktiviteti privat i familjes bujqësore, ullishtë, vreshtari, bujqësi, të cilat ishin investuar në depozita (shuma 50.000 euro), së bashku me interesat e përfituara (3.514,09), janë transferuar në llogarinë e nënës së saj L.M. Këto të ardhura identifikojnë subjektin e rivlerësimit vetëm si depozituese të tyre, ndërsa rezultoi se shuma vazhdon të jetë në bankë dhe nuk është përdorur si burim krijimi për ndonjë pasuri të subjektit apo prindërve të saj.

**21.15** Trupi gjykues konkludon se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar dhe me përgjigjet e bankave përkatëse.

**21.16** Në lidhje po me shumën 53.000 euro të deklaruar nga subjekti në DPV/2011, Komisioni i ka kërkuar subjektit të sqarojë lidhur me likuiditetet në bankë dhe *cash*, pasi në këtë deklaratë rezultoi e deklaruar shuma prej 53.000 euro si e ardhur, ndërkohë nga hetimi rezultoi se vetëm 30.000 euro ishin depozituar në bankë dhe investuar në depozitë në vitin 2011. Ndërsa diferenca prej 20.000 euro ishte depozituar në bankë në gusht të vitit 2012.

**21.17** Subjekti, në përgjigjen e saj, ka deklaruar se: *“...deklarata e parë para fillimit të detyrës mund të jetë shoqëruar edhe me ndonjë lapsus, por pa efekte sepse unë, meqenëse isha në të njëjtin trung familjar me prindërit e mi, kam deklaruar shumën totale të përfituar prej prindërve të mi nga aktiviteti bujqësor, sikurse ata ma kanë cilësuar, që në të vërtetë është e verifikueshme lehtësisht, me shumën e depozitave në bankë. Unë kam deklaruar vetëm të ardhurat e tyre dhe asnjë veprim tjetër, pasi kam menduar që depozitat ishin të verifikueshme, ndërsa pjesa tjetër prej*

20.000 euro që është depozituar në vitin 2012, nuk është deklaruar prej meje si gjendje cash, pasi ishin kursime të prindërve të mi dhe jo të miat. Ato administroheshin prej prindërve të mi. Në vitin 2012 e në vazhdim kam deklaruar interesat e përfituara nga depozitat, si dhe transferimi i tyre në vitin 2015 në llogarinë e nënës time. Ky veprim u krye në këtë vit, pasi unë u transferova në Tiranë<sup>50</sup> dhe për shkak të distancës nuk mund të isha gjithmonë e disponueshme për çdo transfertë të mundshme apo çdo lloj veprimi tjetër të prindërve të mi. Siç vërehet edhe nga statement ato janë akoma në llogarinë e nënës time edhe sot”.

**21.18** Gjithashtu subjekti ka dhënë sqarime edhe në ILDKPKI<sup>51</sup> për depozitat, referuar procesverbalit të mbajtur në dhjetor të vitit 2014, ku për secilën depozitë ka deklaruar të njëjtën përgjigje: “Nuk mendoj se është fshehur nga ana ime kjo depozitë, për faktin se në deklaratën e dorëzuar në datën 14.12.2011 kam deklaruar të ardhura nga aktiviteti privat i familjes bujqësore në shumën 53.000 euro, të cilat duhej t’i deklaroja si gjendje cash në faqen 3, por gabimisht i kam deklaruar në faqen 4 të të ardhurat. Këtë vlerë më pas e kam depozituar në 3 banka të ndryshme të nivelit të dytë”.

**21.19** Në analizën e kryer lidhur me likuiditetet, Komisioni ka marrë në konsideratë gjatë hetimit edhe deklarin e subjektit në ILDKPKI, pasi kursimet e deklaruara kanë qenë të prindërve të saj dhe ata nuk kanë pasur detyrimin ligjor për deklarim.

**21.20** Gjithashtu, nga hetimi ka rezultuar se nëna e subjektit, në datën 8.5.2014 ka çelur një depozitë në “Tirana Bank”. Nëna e subjektit ka depozituar në “Tirana Bank” shumën 20.000 euro, me përshkrimin “depozitë në arkë L.M, të ardhura nga emigracioni + bujqësia”, të cilën më pas e ka investuar në depozitë. Kjo depozitë, pas maturimit, ka gjeneruar 170 euro interesa dhe në datën 3.7.2015 është transferuar në “Intesa Sanpaolo Bank”<sup>52</sup>. Deri në gusht të vitit 2020 kjo depozitë ka arritur vlerën 20.183,88 euro, sipas shkresës kthim përgjigjeje për Komisionin.

**21.21** Meqenëse këto transaksione janë kryer në vitin 2014, kohë kur subjekti nuk është më në trungun familjar me prindërit e saj, por edhe për faktin se shuma vazhdon të jetë në bankë dhe nuk është përdorur si burim krijimi për ndonjë pasuri të subjektit, Komisioni nuk konstaton ndonjë lidhje mes subjektit të rivlerësimit dhe prindërve të saj.

**21.22** Komisioni e ka pyetur subjektin edhe në lidhje me administrimin dhe shpërndarjen e të ardhurave të përfituara nga bujqësia, nga ku ka deklaruar: “Ato kanë qëndruar të pashpërndara ndër vite. Të ardhurat janë ruajtur dhe mbajtur në shtëpi dhe me administrimin e tyre merreshin të dy prindërit. Aktiviteti i bujqësisë është ushtruar me kohë të plotë nga mamaja, pra gjatë gjithë kohës. Ndërsa babai, duke qenë se ishte i punësuar në institucione shtetërore, fakt i cili del nga dosja e punësimit të tij, ka qenë i përfshirë në aktivitetin e bujqësisë me kohë të pjesshme në ditët e javës nga e hëna në të premte dhe me kohë të plotë në fundjavë. Në lidhje me mbajtjen e likuiditeteve kesh nga familja dua të vë në dukje faktin e njohur nga të gjithë se mbajtja e likuiditeteve cash në shtëpi ka qenë një mentalitet i hershëm i familjeve shqiptare, përfshirë këtu prindërit e mi. Siç duket edhe nga llogaria bankare e pagës, babai im sapo i kalonte rroga në llogari e tërhiqte dhe e ruante në shtëpi. E njëjta gjë ka ndodhur edhe me të ardhurat e përfituara nga shpronësimi, të cilat sapo janë transferuar i ka tërhequr dhe i ka ruajtur në shtëpi. Pra të gjitha të ardhurat e siguruar nga familja, si nga paga, edhe nga aktiviteti privat bujqësor e

<sup>50</sup> Me Dekretin Nr. \*\*\*, datë 9.10.2015, jam transferuar nga Prokuroria e Rrethit Gjiqësor Vlorë në Prokurorinë e Rrethit Gjiqësor Tiranë.

<sup>51</sup> Referohuni praktikës së përcjellë me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 9.10.2020.

<sup>52</sup> Referohuni shkresës nr. \*\*\* prot., datë 21. 8.2020, përcjellë nga “Intesa Sanpaolo Bank”.

*blegtoral janë ruajtur në shtëpi. Vendosja e gjendjes së likuiditeteve në bankë u bë pas këmbënguljes time, pasi ishte koha kur unë po përfundoja Shkollën e Magjistraturës dhe nuk dihej sa pranë tyre do të isha. Nisur nga ky fakt dhe me këmbënguljen time të gjitha kursimet janë depozituar në bankë përgjatë viteve 2011 - 2012. Theksoj gjithashtu se babai im nuk është subjekt deklarues dhe madje nuk ka qenë ndonjëherë. Gjithashtu, periudha gjatë të cilës këto të ardhura janë krijuar dhe ruajtur përkon me kohën përpara fillimit të detyrës, kur unë nuk kam qenë subjekt deklarues. Pra, as unë dhe as babai im nuk kemi qenë subjekte deklaruese në periudhën kohore 1994 – 2011, kohë kur ishte krijuar shuma e të ardhurave objekt hetimi”.*

**21.23** Subjekti i rivlerësimit, për të provuar të ardhurat e siguruara nga aktiviteti bujqësor, ka depozituar edhe raportin e vlerësimit ekonomik - bujqësor të hartuar nga agronomi dhe veterineri i Njësisë Administrative N, Bashkia Vlorë<sup>53</sup>, i bazuar në sipërfaqen e tokës në emër të kryefamiljarit LL.K.M, në numrin e rrënjëve të ullinjve, numrin e gjedhëve dhe shpendëve, sipas të dhënave të administruara nga kjo njësi. Raporti i hartuar ka përcaktuar të ardhurat, fitimin *neto*, si dhe shpenzimet për rritjen dhe mirëmbajtjen e ullirit, kostot vjetore për prodhimet bujqësore, blegtorale dhe shpendarisë (pesticide, plehërim, punim toke, vaksinim, etj.) për periudhën 1993 – 2016. Sipas këtij raporti, të ardhurat *neto* për periudhën 1994 – 2011, të cilat kanë shërbyer si burim krijimi për blerjen e apartamentit, rezultojnë në vlerën 17.280.600 lekë.

**21.24** Komisioni, deri në këtë fazë të hetimit, vlerësoi të mos konsiderojë të ardhurat e përfituara nga aktiviteti bujqësor dhe blegtoral i prindërve të subjektit, pasi dokumentacioni i depozituar nga subjekti, dhe specifikisht raporti i vlerësimit ekonomik - bujqësor i hartuar nga agronomi dhe veterineri i Njësisë Administrative N, Bashkia Vlorë, dukej se: (a) nuk përmbante të dhëna të detajuara që tregonin se cilat fakte ose rrethana ishin shqyrtuar/vërtetuar; (b) nuk shpjegonte se cilat metoda apo ekzaminime ishin aplikuar; (c) nuk përmbante standarde ose të dhëna zyrtare të njohura për produktivitetin/çmimet/shpenzimet e kryera të mirëmbajtjes për aktivitete të tilla që ekzistonin në atë kohë dhe që mund të ishin lehtësisht të aksesueshme nga burime të hapura; si dhe (ç) nuk referonte të dhëna se ku ishin bazuar hartuesit e raportit në përfundimet e tyre.

**22. Garazh me sip. 23,04 m<sup>2</sup>**, regjistruar në ZVRPP-në Vlorë, me nr. pasurie \*\*\*, blerë me kontratën e shitjes nr. \*\*\*, datë 10.9.2012, me vlerë 500.000 lekë, me të ardhura nga paga e punës dhe aktivitetit privat bujqësor të familjes bujqësore (sqarim: garazhi është në bashkëpronësi të familjes bujqësore të origjinës e përbërë nga 5 anëtarë). Pjesa takuese: 20%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente<sup>54</sup>.

## Hetimi i Komisionit

**22.1** Nga hetimi rezultoi se subjekti i rivlerësimit e deklaroi për herë të parë këtë pasuri në deklaratën e interesave privatë periodikë vjetorë për vitin 2012, me përshkrimin “Më datë 10.9.2012, kontratë shitjeje për blerje garazh, nr. \*\*\*, sip. 23,04 m<sup>2</sup>, me të ardhura nga puna dhe nga aktivitet privat. Vlera: 500.000 lekë”.

<sup>53</sup> Referohuni shkresës nr. \*\*\* prot., datë 1.11.2022, me të cilën kërkohet nga subjekti i rivlerësimit informacion i shoqëruar me akte pranë Njësisë Administrative N; shkresës nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2022, si dhe raportit përkatës, depozituar nga subjekti i rivlerësimit.

<sup>54</sup> Kontratë shitje nr. \*\*\*, datë 10.9.2012, me palë shitëse E.H dhe palë blerëse Armida Moçka, për blerje garazhi me sip. 23,04 m<sup>2</sup>, vlera 500.000 lekë; certifikatë për vërtetim pronësie nr. \*\*\*, datë 28.5.2012, për garazh me sip. 23,04 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, Vlorë, në pronësi të shtetasit E.H + kartelë pasurie; certifikatë për vërtetim pronësie nr. \*\*\*, datë 17.9.2012, për garazh me sip. 23,04 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol.\*\*\*, f.\*\*\*, Vlorë, në pronësi të znj. Armida Moçka + kartelë pasurie. Aneks nr. \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.

**22.2** Kjo pasuri konfirmohet sipas kontratës së shitjes nr. \*\*\*, datë 10.9.2012, me palë shitëse E.H dhe palë blerëse Armida Moçka, për blerje garazhi me sip. 23,04 m<sup>2</sup>, në vlerën 500.000 lekë, e cila është likuiduar jashtë zyrës noteriale.

**22.3** Nga korrespondenca e mbajtur me institucionet publike rezultoi se ZVRPP-ja Vlorë<sup>55</sup> konfirmon që znj. Armida Moçka ka të regjistruar pasurinë garazh me sip. 23,04 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\* dhe njëkohësisht ka vendosur në dispozicion të njëjtën kontratë shitjeje si edhe subjekti.

**22.4** Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se si burim për krijimin e kësaj pasurie kanë shërbyer të ardhurat nga paga dhe aktiviteti privat bujqësor i familjes bujqësore. Komisioni e ka pyetur subjektin se sa ka qenë kontributi i saj nga paga dhe sa nga aktiviteti bujqësor, e cila, në përgjigjen e saj, ka sqaruar: “...në lidhje me vlerën prej 500.000 lekësh të paguar për blerjen e garazhit deklaroj se nga ky çmim janë paguar 3.000 euro nga të ardhurat e aktivitetit privat bujqësor dhe blegtoral. Kjo shumë e konvertuar nga euro në lekë sipas kursit zyrtar të këmbimit të datës 10.9.2012, 1 (një) euro e barabartë me 138,09 lekë, ishte 414.270 lekë. Pjesa tjetër e çmimit, diferenca në shumën 85.730 lekë, është paguar me të ardhurat nga paga e funksionit si prokurore”.

**22.5** Komisioni, për të analizuar të ardhurat nga puna e subjektit, ka administruar vërtetimet nga institucioni punëdhënës. Në këtë rast ligjërimi i të ardhurave është në përmbushje të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, ndërsa krijimin dhe ligjërimin e të ardhurave nga aktiviteti privat i familjes bujqësore Komisioni e trajton në vijim në këtë vendimmarje.

**22.6** Komisioni hetoi edhe në lidhje me ekzistencën e ndonjë konflikti të mundshëm interesi të subjektit të rivlerësimit me shitësin e pasurisë, për shkak të funksionit. Subjekti ka deklaruar se ajo nuk ka hetuar çështje me këtë person dhe në funksion të këtij deklarimi ka depozituar vërtetimet<sup>56</sup> përkatëse nga institucionet punëdhënëse. Nga informacioni i administruar, trupi gjykues nuk konfirmon të dhëna për të konkluduar në ndonjë konflikt të mundshëm interesi midis subjektit dhe shitësit të pasurisë. Në të tilla kushte, provohet gjithashtu se subjekti ka deklaruar me vërtetësi mbi këtë fakt.

**23.** Nga hetimi i kryer, rezultoi se subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* si pjesë zotëruese në pasuritë e prejardhura nga aktiviteti bujqësor dhe blegtoral, në masën 20%. Gjithashtu u konstatua se subjekti nuk ka deklaruar pjesë takuese në deklaratën para fillimit të detyrës dhe as në DPV/2011.

**23.1** Subjekti është pyetur<sup>57</sup> në lidhje me këtë konstatim në raport me faktin se pasuritë e paluajtshme rezultuan të regjistruara në emër të saj.

**23.2** Në përgjigjen e dhënë subjekti ka deklaruar: “Pavarësisht se pasuritë rezultojnë të regjistruara vetëm në emrin tim dhe jo në emër të të gjithë anëtarëve të familjes, kjo ka qenë një zgjedhje e momentit e vendosur nga të gjithë anëtarët e familjes (prindërit, motra dhe vëllai), si dhe nga fakti që prindërit më besojnë shumë të drejta, nga fakti që motra dhe vëllai jetojnë jashtë shtetit - në Itali, nga fakti që midis nesh, pra në familjen tonë, ka një raport të shëndetshëm besimi reciprok, si dhe nga fakti që isha i vetmi fëmijë i familjes që banoja në Shqipëri. Prindërit kanë

<sup>55</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 4.9.2017, aneks nr. \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>56</sup> Nr. \*\*\* prot., datë 1.11.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe nr. \*\*\* prot., datë 3.11.2022, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>57</sup> Me pyetësin nr. 2, datë 28.10.2022.

*jetuar dhe jetojnë në fshat, për lehtësi veprimesh me bankën i kam kryer unë veprimet. Si pagesat ndaj shoqërisë, edhe depozitimi i kursimeve në bankë dhe investimi i tyre në depozita janë kryer të gjitha nga unë dhe janë veprime lehtësisht të verifikueshme. Meqenëse kur kam kryer deklarin kam pasur në konsideratë konceptin dhe faktin e familjes bujqësore dhe AMTP-në që sipas 1991-it figurojmë të gjithë sipas certifikatës së vitit 1991<sup>58</sup>, kështu që pjesa ime takuese është 1/5 ose 20%. Pavarësisht se për të qenë korrekt me ligjin dhe mënyrën e ndarjes sipas ligjit, dua të theksoj se në familjen tonë nuk ka pjesë të ndara. Prindërit tanë na kanë qëndruar gjithmonë pranë për çdo nevojë tonën dhe nuk bëjnë dallime mes nesh (vëllait, motrës dhe mua)”*

**23.3** Subjekti ka referuar nenet 222 dhe 223 të Kodit Civil lidhur me përcaktimin e konceptit të bashkëpronësisë midis anëtarëve të familjes bujqësore. Subjekti ka sqaruar se familja e saj bujqësore, sipas certifikatës familjare të gjendjes civile në datën 1.8.1991, ka qenë e përbërë prej 5 anëtarësh.

**23.4** Sipas subjektit, bazuar në këtë përbërje familjare përfitohej edhe toka bujqësore, me formulën 5 pjesëtar të familjes bujqësore, shumëzim normën për frymë takuese të tokës bujqësore dhe, për rrjedhojë, ka theksuar se pjesa e saj takuese në sipërfaqen e tokës bujqësore të përfituar në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, ashtu dhe në pronësinë mbi pasurinë e anëtarëve të familjes bujqësore, sipas nenit 222 e vijues të Kodit Civil, është 1/5 ose 20%.

**23.5** Subjekti ka theksuar gjithashtu faktin se toka bujqësore e përfituar në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, është regjistruar vetëm në emër të kryefamiljarit të familjes bujqësore (babait të subjektit), por de jure kjo pasuri e paluajtshme është në bashkëpronësi të familjes bujqësore, në pjesën takuese 1/5 të secilit prej anëtarëve të saj dhe se realisht në familjen e saj nuk ka pasur pjesë të ndara.

**23.6** Subjekti ka sqaruar se apartamenti objekt hetimi përdoret nga e gjithë familja e origjinës (sa herë që prindërit e saj vijnë për pushime ose sa herë që vëllai dhe motra kthehen në Shqipëri). Për këtë subjekti referon faturimet e energjisë elektrike, të cilat, pas largimit të saj në Tiranë<sup>59</sup>, janë fikse dhe hera-herës kanë një vlerë të caktuar.

**23.7** Subjekti, për të provuar deklarinimet e saj, ka depozituar deklaratat noteriale<sup>60</sup> të anëtarëve të familjes, ku nga verifikimi përkatës rezulton se të gjithë anëtarët deklarojnë pjesën e tyre takuese në pasuritë e përfituara në zbatim të ligjit nr. 7501/1991 dhe të administruara me pasojë përfitimin e të ardhurave në mënyrë të përbashkët dhe po ashtu edhe në pronësinë e apartamentit objekt hetimi administrativ i blerë në emër të subjektit të rivlerësimit, por i deklaruar në bashkëpronësi të familjes bujqësore. Duket se në deklarinimet e tyre, si prindërit e subjektit, po ashtu edhe vëllai dhe motra e tij, sillen si bashkëpronarë në pjesë takuese të barabarta, pa pasur asnjë kundërshti mes njëri-tjetrit.

---

<sup>58</sup> Një kopje e certifikatës së përbërjes familjare të datës 1.8.1991 i bashkëlidhet përgjigjes.

<sup>59</sup> Me Dekretin Nr. \*\*\*, datë 9.10.2015, jam transferuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>60</sup> Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 1.11.2022, lëshuar nga babai i subjektit LL.K.M, 4 faqe; deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 3.11.2022, lëshuar nga nëna e subjektit L.XH.M, 14 faqe; deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 6.11.2022, lëshuar nga vëllai i subjektit S.LL.M, 4 faqe; deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 7.11.2022, lëshuar nga motra e subjektit S.LL.M, 4 faqe. Akte të administruara me pyetësin nr. 2, datë 28.10.2022.

**23.8** Duke iu referuar praktikës së regjistrimit të pasurive rezulton se ato janë regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit, ndërsa në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar si pjesë takuese 20% të pasurive.

**24.** Për sa më sipër, lidhur me pasuritë e deklaruara dhe përshkruara më lart, hetimi administrativ i Komisionit evidentoi të njëjtat konstatime lidhur me deklarinimin e subjektit për pjesën takuese dhe provueshmërinë e burimit të krijimit dhe, për rrjedhojë, i kaloi subjektit barrën e provës, pasi: (i) dukej se familja e subjektit nuk kishte pasur mundësi financiare në shumën 50.000 euro të investonte në blerjen e apartamentit, të kursente 53.000 euro (ku 3.000 euro kanë shërbyer për blerjen e garazhit) dhe të përballonte shpenzimet e tjera familjare; si dhe (ii) të jepte shpjegime lidhur me deklarinimin e saj për pjesën takuese 20%, në raport me regjistrimin e pasurive 100% në emër të saj.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**25.** Subjekti ka parashtuar në prapësime se, sikurse ka deklaruar në pyetësorin nr. 2, pjesën takuese nuk e ka saktësuar në deklaratën para fillimit të detyrës, nisur nga fakti që kur ka deklaruar për herë të parë ka pasur në konsideratë konceptin e familjes bujqësore, sipas AMTP-ve dhe përbërjen familjare të vitit 1991, ku figurojnë të gjithë sipas certifikatës së vitit 1991, si dhe faktin që kjo pronë është blerë edhe me të ardhurat dhe kursimet e krijuara nga aktiviteti privat i familjes bujqësore me kryefamiljar shtetasin LL.K.M, kështu që pjesa e saj takuese është 1/5 ose 20%. Subjekti ka vijuar të deklarojë se nuk i është dhënë ndonjë rëndësi esenciale këtij momenti dhe se nuk është treguar ndonjë vëmendje e shtuar për këtë fakt, për sa kohë e kishte të qartë që pjesa e saj takuese mbi këtë pasuri, ashtu siç është edhe në tokën bujqësore, përfituar në bazë të ligjit nr. 7501/1991, “Për tokën”, është në masën 20%.

**25.1** Subjekti ka shpjeguar se pjesa e saj takuese është pasqyruar qartë në deklaratën *Vetting*, gjatë plotësimit të së cilës ka treguar kujdesin e shtuar dhe se në asnjë moment nuk ka shënuar apo deklaruar që pjesa e saj takuese është 100%.

**25.2** Subjekti ka deklaruar se nisur edhe nga fakti që ky apartament përdoret vazhdimisht nga të gjithë pjesëtarët e familjes së origjinës, provohet se është në bashkëpronësi të familjes bujqësore. Ky defekt nuk është vënë në dukje as në momentin kur është thirrur për të dhënë sqarime pranë ILDKPKI-së.

**25.3** Sipas subjektit, në momentin që e ka deklaruar në deklaratën *Vetting* ka treguar kujdesin e shtuar, duke saktësuar pjesën takuese që i përket, se shuma 50.000 euro e investuar për blerjen e apartamentit është krijuar nga aktiviteti privat i familjes bujqësore të origjinës përpara fillimit të detyrës së saj si prokurore, në periudhën 1994 – 2011 dhe se asnjë prej anëtarëve të familjes së saj të origjinës nuk ka qenë subjekt deklarues, as në kohën kur ishin krijuar këto të ardhura, madje në asnjë moment tjetër më vonë.

**25.4** Subjekti ka referuar nenet 222 dhe 223 të Kodit Civil dhe ndërkohë ka theksuar se edhe toka bujqësore e përfituar në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, është regjistruar vetëm në emër të kryefamiljarit të familjes bujqësore (babait të saj), por *de jure* kjo pasuri e paluajtshme është në bashkëpronësi të familjes bujqësore, në pjesën takuese prej 1/5 të secilit prej anëtarëve të saj. Në lidhje me pasaktësitë e konstatuara në deklaratat periodike vjetore, subjekti ka pretenduar që Komisioni t’i referohet praktikës gjyqësore të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, vendimit nr. \*\*\*, ku citohet: “23.2. *Ballafaqimi i deklarimeve të pasurisë periodike/vjetore me ato të bëra në deklaratën e pasurisë Vetting, u jep mundësi institucioneve të rivlerësimit për të arritur në*

*përfundimin nëse është bërë deklarim i saktë ose i pasaktë i pasurisë në deklaratën Vetting është bërë ose jo fshehje e kësaj pasurie, nëse është i justifikuar burimi i ligjshëm i të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e saj”.*

**25.5** Ndërsa në lidhje me konstatimin e Komisionit mbi pasaktësinë në deklaratën Vetting ku ka deklaruar 20% pjesë takuese, edhe pse pasuria rezulton të jetë e regjistruar vetëm në emrin e saj, subjekti ka shpjeguar, sikurse ka deklaruar edhe në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, duke marrë në konsideratë faktin që për blerjen e kësaj pasurie janë përdorur edhe të ardhurat dhe kursimet e krijuara nga aktiviteti privat i familjes bujqësore me kryefamiljar LL.K.M, në shumën 3.000 euro.

**25.6** Për të provuar ekzistencën e familjes bujqësore, subjekti ka ricituar edhe një herë të gjithë provat e depozituara gjatë hetimit administrativ<sup>61</sup>. Subjekti ka theksuar se me provat shkresore të depozituara provohet fakti se familja bujqësore ka paguar rregullisht taksën për tokën bujqësore, si i vetmi detyrim që ekziston për familjen bujqësore, si dhe sigurimet shoqërore, bazuar në ligjin nr. 7703/1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

**25.7** Ndërsa për të provuar aktivitetin e familjes bujqësore në ullishtë, ka ricituar provat e depozituara më parë gjatë hetimit, ku përfshihen të dhëna e informacione nga njësia administrative N, mandatarkëtime dhe mandatpagesa, fletë regjistrimi për kultura të ndryshme në shërbim të zhvillimit të aktivitetit bujqësor e blegtoral, etj. Subjekti ka sqaruar se me provat shkresore të paraqitura, pjesa e konsiderueshme e të cilave janë akte zyrtare me fuqi të plotë provuese, provohet fakti se familja bujqësore me përfaqësues LL.M ka \*\*\* rrënjë ullinj kaninjot shekullorë, si dhe \*\*\* rrënjë frantoil, të cilët kanë hyrë në prodhim në vitin 1996. Prodhimtaria e këtyre ullinjve është shitur rregullisht për periudhën 1994 – 2011.

**25.8** Subjekti ka cituar edhe provat e depozituara lidhur me provueshmërinë e aktivitetit të familjes bujqësore në blegtori, përfshirë: certifikatën e regjistrimit të fermerit LL.K.M, babait të saj, kopjen e të dhënave të printuara nga sistemi Ruda – Sistemi i Informacionit Blegtoral dhe Veterinar pranë Drejtorisë Rajonale Veterinare dhe Mbrojtjes së Bimëve Vlorë, për të provuar që fermeri LL.K.M është marrë me veprimtarinë e mbarështimit të gjedhëve, deklaratën noteriale; kopje të vërtetimit nr. \*\*\* prot., datë 10.7.2020, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve Vlorë, me të cilin vërtetohet se për periudhën 1993 – 2010 nuk rezulton të ketë regjistër për numrin e krerëve të gjedhëve të familjeve bujqësore; vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 9.12.2022, të Drejtorisë Rajonale të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve Vlorë; si dhe kopje të regjistrimit të fermës (Sistemi i Informacionit Blegtoral dhe Veterinar). Subjekti ka theksuar se me provat shkresore të cituara më sipër provohet fakti se familja bujqësore, me përfaqësues LL.M, për vitet 1994 – 2011 ka mbarështuar \*\*\* gjedhë dhe rreth \*\*\* gjela e pula deti, si dhe ka tregtuar prodhimtarinë e tyre për këtë periudhë.

**25.9** Subjekti, për të provuar të ardhurat e përfituara nga familja e saj bujqësore, krahas dokumentacionit të depozituar gjatë hetimit administrativ, ka vendosur në dispozicion të Komisionit disa prova të reja që i përkasin informacionit të dhënë nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Instituti i Statistikave (INSTAT) dhe Qendra e Transferimit të Teknologjive

---

<sup>61</sup> Një kopje e vërtetimit për të vetëpunësuar në bujqësi në emër të shtetasës L.XH.M, lëshuar nga ISSH-ja Vlorë, 3 faqe; një kopje e librezës së kontributeve të sigurimeve shoqërore të derdhura në emër të shtetasës L.XH.M, 4 faqe; një kopje e vërtetimit nr. \*\*\* prot., datë 23.6.2020, lëshuar nga Njësia Administrative N, Drejtoria e Tatim-Taksave, nga e cila rezulton se fermeri LL.K.M nuk ka detyrime për tokën bujqësore, 1 faqe; një kopje e vërtetimit nr. \*\*\* prot., datë 1.7.2020, lëshuar nga Njësia Administrative N, Bashkia Vlorë, me të cilin provohet fakti se fermeri LL.K.M tokën që ka në pronësi dhe përdorim e ka punuar gjithë kohës dhe ka paguar rregullisht detyrimet për tokën, 1 faqe.

Bujqësore Vlorë. Subjekti ka shpjeguar se informacionin dhe dokumentacionin e marrë nga këto institucione e ka vendosur në dispozicion të dy ekspertëve të fushës (inxhinier dhe agronom për vlerësimin e pasurive të paluajtshme) për të hartuar raport-vlerësimin tekniko-agronom-ekonomik.

**25.10** Subjekti i rivlerësimit ka depozituar raportin tekniko-agronomik-ekonomik dhe ka shpjeguar lidhur me të. Më konkretisht, ndër të tjera, ka theksuar se aktekspertimi është i qartë në formë e përmbajtje, i bazuar në metodën e krahasimit dhe vlerësimit të drejtpërdrejtë të gjendjes së tokës, indikatorëve të fertilitetit të dheut, lagështirës dhe kapacitetit produktiv si bazë e vlerësimit të resurseve për tokën, si dhe në metodën e analizës së faktorëve agronomikë, si faktorë përcaktues në prodhimin bujqësor (bimë, klimë, tokë) dhe harmonizimin e tyre, etj. Subjekti ka sqaruar se aktekspertimi duhet të konsiderohet me fuqi të plotë provuese gjatë këtij procesi administrativ, pasi është i miranalizuar, me bazë shkencore dhe ligjore.

**25.11** Po ashtu, subjekti, në prapësimet e saj, ka dhënë sqarime mbi këto të ardhura, duke paraqitur një analizë të të dhënave të dala nga aktekspertimi, duke pretenduar se shuma e siguruar nga aktiviteti bujqësor ullishtë dhe blegtori në harkun kohor prej 18 vjetësh në shumën 103.000 euro e pjesëtuar me 216 muaj (18 vjet x 12 muaj viti) është 476 euro për muaj (103.000 euro/216 muaj), është sa një pagë në sektorin publik ose privat për një individ.

**25.12** Subjekti, si prova të reja, të cilësuarat prej saj si akte zyrtare me fuqi të plotë provuese, ka depozituar: kthim përgjigjen nga QTTB-ja Vlorë; kthim përgjigjen nga INSTAT-i; kthim përgjigjen nga Ministria e Bujqësisë; vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 9.12.2022, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Veterinarisë dhe e Mbrojtjes së Bimëve Vlorë, nga i cili rezulton se fermeri LL.K.M, për periudhën 1993 – 2013, ka mbarështuar \*\*\* krerë gjedhë dhe pula, si dhe ka sqaruar se aktekspertimi është bazuar edhe në të dhënat e këtyre institucioneve, krahas gjithë dokumentacionit tjetër të vënë në dispozicion në Komision gjatë hetimit dhe se ekspertët për përpilimin e këtij akti tekniko-agronomik-vlerësues privat ekspertimi kanë shfrytëzuar burime informacioni mbështetur në të dhëna statistikore, në referenca të dhëna nga institucionet shtetërore, botime shkencore, etj.

**25.13** Mbi shpjegimet e dhëna dhe dokumentacionin e depozituar, subjekti ka kërkuar të administrohet në cilësinë e provës akti tekniko-agronomik-vlerësues i përgatitur nga ekspertët dhe të vlerësohet si provë e plotë, në koherencë dhe në tërësi me provat e tjera që ka dorëzuar pranë Komisionit dhe që janë bërë pjesë e dosjes, sikundër ka vepruar Komisioni dhe Kolegji tek rasti i subjektit I. M.<sup>62</sup>

**25.14** Subjekti ka referuar gjithashtu disa prej vendimeve të formës së prerë të Komisionit<sup>63</sup>, si dhe një tjetër vendim të Kolegjit<sup>64</sup>, për të cilat ka theksuar ngjashmërinë me rastin e çështjes së saj objekt hetimi administrativ, duke cituar shprehimisht edhe pjesë nga arsyetimet e tyre, por edhe duke theksuar herë pas here provat thuajse të njëjta të depozituara si në rastet e subjekteve të tjera, madje në rastin e saj ajo ka theksuar se ka depozituar një numër më të konsiderueshëm provash për të provuar ligjshmërinë e të ardhurave të krijuara nga aktiviteti i familjes bujqësore.

**25.15** Subjekti, mbi këto vendime referuese, është shprehur se për të provuar të ardhurat dhe kursimet e gjeneruara nga aktiviteti privat i familjes bujqësore, kryesisht janë depozituar dhe konsideruar si prova certifikata e përbërjes familjare e datës 1.8.1991, vërtetim që familja

<sup>62</sup> Referohuni vendimit nr. \*\*\*, datë 14.6.2022, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

<sup>63</sup> Vendimet nr. \*\*\*, datë 16.3.2021, nr. \*\*\*, datë 23.6.2022, nr. \*\*\*, datë 4.2.2020, nr. \*\*\*, datë 26.7.2019, nr. \*\*\*, datë 6.9.2019 dhe nr. \*\*\*, datë 22.4.2021, të Komisionit.

<sup>64</sup> Vendimin nr. \*\*\*, datë 17.3.2022.



bujqësore ka paguar taksat për tokën bujqësore pranë institucioneve vendore dhe vërtetime mbi pagesat e kryera të kontributeve si të vetëpunësuar në bujqësi, dokumente këto mbi të cilat janë konsideruar të ardhurat e ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

**25.16** Subjekti ka referuar vendimin nr. \*\*\*, datë 14.6.2022, të Kolegjit ku, sipas saj, aktualisht është krijuar precedent juridik për të ardhurat dhe kursimet e krijuara nga aktiviteti privat i familjes bujqësore dhe, për pasojë, kërkon që të zbatohen të njëjtat standarde arsytimi dhe vlerësimi, të konsiderohet aktekspertimi privat, dorëzuar prej saj si provë me fuqi të plotë provuese dhe, si i tillë, të pranohet së bashku me provat e reja, akte zyrtare po me fuqi të plotë provuese të dorëzuara prej saj, së bashku me prapësimet dhe, për rrjedhojë, të konsiderohen të ligjshme të ardhurat e krijuara nga aktiviteti privat i familjes bujqësore me kryefamiljar fermerin, babain e saj, z. LL.K.M. Këto të ardhura kanë shërbyer për pagimin e kësteve të apartamentit, përbalimin e shpenzimeve të jetesës së kësaj familjeje dhe krijimin e depozitës bankare objekt hetimi.

**25.17** Subjekti është ndalur edhe te vendimi nr.\*\*\*, datë 17.3.2022, i Kolegjit, duke theksuar se edhe në këtë rast ku është hetuar, ndër të tjera, për burimin e ligjshëm të krijimit të një pasurie, banesë trekatëshe, Kolegji ka pranuar se ndërtimi i kësaj pasurie ishte kryer në kohën që subjekti i rivlerësimit nuk kishte qenë duke ushtruar detyrën e prokurorit, por gjatë kohës që kishte qenë duke ushtruar profesionin e avokatit dhe se janë pranuar të ardhurat e siguruara nga ushtrimi i këtij profesioni, duke u bazuar në prova jo të drejtpërdrejta, pasi subjekti kishte depozituar vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbi regjistrimin e subjektit, konfirmimin e pajisjes me licencë dhe vërtetimin e pagesës së kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore, duke arsytuar mbi bazën e këtyre provave.

**25.18** Subjekti ka sqaruar se në provat e dorëzuara prej saj, bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorëve dhe bazuar në provat që ka paraqitur në prapësime, provohet që prindërit kanë jetuar në mënyrë të pandërprerë në fshatin M, Njësia Administrative N, Bashkia Vlorë, janë trajtuar me tokë bujqësore sipas ligjit “Për tokën”, kanë paguar rregullisht detyrimet financiare pranë organeve tatimore që lidhen me tokën, si dhe nëna e saj, znj. L.M, e vetëpunësuar në bujqësi, ka paguar rregullisht dhe në mënyrë të pandërprerë kontributet e sigurimeve shoqërore.

**25.19** Subjekti ka vijuar të shpjegojë në prapësime në lidhje me përmbushjen e kërkesave të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe, për këtë, ka theksuar mungesën në këtë dispozitë ligjore të parashikimit të detyrimit tatimor për të ardhurat e përfituara nga vetëpunësimi në bujqësi, pasi referuar legjislacionit në fuqi, nga viti 1994 e deri aktualisht, vetëm toka bujqësore është objekt taksimi dhe jo të ardhurat që gjeneron ajo. Subjekti ka qartësuar se fermerët nuk deklarojnë të ardhura mbi produktet e tyre dhe se detyrimi që prodhuesit e produkteve bujqësore, në këtë rast kultivuesit e ullirit dhe produkteve blegtorale, kanë kundrejt organeve shtetërore, janë taksat vendore për tokën bujqësore, të parashikuara nga neni 9, pika 2 e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, për të cilën ka deklaruar se me pyetësorin nr. 2 ka depozituar vërtetime të lëshuara nga Njësia Administrative N, që provojnë se fermeri LL.K.M (babai i saj) ka paguar taksën e tokës bujqësore deri më 31.12.2021.

**25.20** Subjekti ka shpjeguar se në lidhje me të ardhurat dhe kursimet e krijuara nga aktiviteti privat i familjes bujqësore me kryefamiljar LL.K.M (babai i subjektit), familja e saj e origjinës ka bërë një jetesë modeste dhe jo luksi. Deri në vitin 2011, kur kishte deklaruar për herë të parë, prindërit LL.K.M dhe L.XH.M, nuk kanë dalë asnjëherë nga territori i Republikës së Shqipërisë. Për herë të parë ata e kanë kaluar kufirin shqiptar në tetor të vitit 2014, në kohën kur kanë shkuar për të

marrë pjesë në ceremoninë e diplomimit të motrës së saj S.M. Këto fakte, ka theksuar subjekti, tregojnë se ata kanë qenë të rezervuar në shpenzimet e tyre, duke bërë një jetë të thjeshtë.

**25.21** Subjekti, nën këto referenca, ka kërkuar: (i) të konsiderohen të ardhurat e krijuara nga aktiviteti privat i familjes bujqësore me kryefamiljar LL.K.M, sikundër janë deklaruar prej saj, të ardhura të ligjshme, të ardhura të krijuara përpara fillimit të detyrës si prokurore; (ii) të konsiderohet vërtetimi nr. \*\*\* prot., datë 9.12.2022, i Drejtorisë Rajonale të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve Vlorë, ashtu edhe regjistri i fermës (Sistemi i Informacionit Blegtoral dhe Veterinal) si akte zyrtare me fuqi të plotë provuese, pasi janë përpiluar nga nëpunës shteti që ushtrojnë veprimtari publike brenda kufijve të kompetencës së tyre dhe në formën e caktuar; si dhe (iii) të konsiderohet aktekspertimi privat, i dorëzuar prej saj si provë shkencore me fuqi provuese, duke qenë se është i qartë në formë dhe përmbajtje dhe bazohet në këqyrjen në vend, në të dhëna studimore, statistikore, eksperiencia ekonomike dhe agronomike. Në këtë rrjedhë kërkimesh, subjekti ka kërkuar të konsiderohen të ligjshme të ardhurat e krijuara nga aktiviteti privat i familjes bujqësore me kryefamiljar fermerin LL.K.M, të ardhura të cilat kanë shërbyer për pagimin e kësteve të apartamentit, përballimin e shpenzimeve të jetesës së kësaj familjeje dhe krijimin e depozitës bankare objekt hetimi, të vlerësohet veprimtaria e aktivitetit privat të familjes bujqësore të origjinës të saj – jo e një rëndësie të veçantë dhe dominuese në drejtim të subjektit, duke e parë këtë në raport me qëllimin e vet ligjit, i cili normon procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, në fokus të të cilit është kontrolli i pasurive dhe i sjelljes profesionale dhe etike të subjekteve të rivlerësimit gjatë kohës së ushtrimit të detyrës.

**25.22** Subjekti, edhe lidhur me deklarin e bërë për pasurinë garazh, ka sqaruar se qëndrojnë të njëjtat parashtrime sikurse ka shpjeguar më sipër për të provuar ligjshmërinë e të ardhurave dhe kursimeve të krijuara nga aktiviteti privat i familjes bujqësore të origjinës, të cilat kanë shërbyer për pagimin e kësteve të apartamentit, përballimin e shpenzimeve të jetesës së familjes së saj të origjinës dhe krijimin e depozitës bankare objekt hetimi. Kjo, ka theksuar subjekti, për faktin se edhe shuma 3.000 euro, e përdorur për blerjen e kësaj pasurie, është krijuar nga aktiviteti privat i familjes bujqësore të origjinës përpara fillimit të detyrës së saj si prokurore dhe se asnjë prej anëtarëve të familjes së saj të origjinës nuk ka qenë subjekt deklarues as në kohën kur ishin krijuar këto të ardhura, madje në asnjë moment tjetër më vonë.

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**25.23** Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit, dokumentacionit të administruar gjatë hetimit, si dhe në prapësime, në analizë të të gjitha fakteve dhe rrethanave të rezultuara gjatë hetimit administrativ, arsyeton si vijon:

**25.24** Në lidhje me deklarin e subjektit në deklaratën *Vetting*, për pjesën takuese 20%, pavarësisht pretendimit të saj se ky deklarin i referohet konceptit të familjes bujqësore, trupi gjykues çmon se për sa kohë pasuria është regjistruar në emër të subjektit 100%, atëherë subjekti ka kryer deklarin të pasaktë.

**25.25** Trupi gjykues çmon se kjo pasaktësi në balancë me faktet provuese se: (i) subjekti ka deklaruar të njëjtën pjesë takuese në këto pasuri, si dhe në depozitën me vlerë 53.000 euro, si në deklaratën *Vetting*, por edhe gjatë hetimit; (ii) pasuritë janë krijuar përpara ushtrimit të detyrës nga subjekti; (iii) u provua që subjekti në mënyrë konsistente ka deklaruar të njëjtin burim krijimi; (iv) u provua që subjekti në deklaratën para fillimit të detyrës nuk ka deklaruar pjesë takuese të pasurisë, të ndryshme nga deklarimi në deklaratën *Vetting*, e cila ka vijuar të mos kontestohet prej

saj dhe familjarëve<sup>65</sup> të saj përgjatë hetimit administrativ; (v) nga hetimi nuk u konkludua në të tjera burime krijimi përveçse të ardhurave të familjes bujqësore dhe në raport edhe me të gjitha rrethanat dhe provat e konstatuara për burimin e ligjshmërisë së të ardhurave për familjen bujqësore – nuk ka peshë të tillë që të mund të cenojë procesin e rivlerësimit të saj.

**25.26** Trupi gjykues, pavarësisht qëndrimit të subjektit se ka vepruar si anëtare e familjes bujqësore, pasi në konceptin e saj i është referuar dispozitave ligjore të Kodit Civil<sup>66</sup>, këtë çështje objekt vlerësimi, për sa është konkluduar në pikën 25.25, e ka lidhur thelbësisht nën faktin se pasuritë janë krijuar para ushtrimit të detyrës nga subjekti, me burim krijimi po para kësaj kohe dhe se nga hetimi nuk u evidentuan rrethana të tjera që impaktojnë pozitën e subjektit apo nuk u konkludua në të tjera burime krijimi, që mund të cenonin procesin e rivlerësimit të saj.

**25.27** Në lidhje me ligjshmërinë e krijimit të të ardhurave për krijimin e pasurisë apartament në shumën 50.000 euro, krijimin e depozitës me vlerë 53.000 euro, si dhe blerjen e garazhit, deklaruar para fillimit të detyrës në vitin 2011, me të njëjtin burim krijimi nga të ardhurat e familjes së saj të origjinës nga aktiviteti bujqësor e blegtoral, trupi gjykues e ka fokusuar analizën në drejtim të: (i) ekzistencës së pasurisë së familjes bujqësore; (ii) provueshmërisë së ushtrimit të aktivitetit bujqësor e blegtoral; si dhe (iii) nivelit të provueshmërisë së të ardhurave të krijuara nga ky aktivitet, sikurse do të arsyetohet në vijim.

**25.28** Lidhur me çështjen e ekzistencës së pasurisë së familjes bujqësore, trupi gjykues vlerëson se nga faktet e dala nga hetimi u provua që familja bujqësore, me kryefamiljar babain e subjektit të rivlerësimit, ka përfituar sipas ligjit nr. 7501/1991, “Për tokën”, tokë arë, në pronësi, me sip. 18.619 m<sup>2</sup>, ndarë në tokë bujqësore arë në fshatin M, me sip. 14.519 m<sup>2</sup>, tokë bujqësore vresht me sip. 1.100 m<sup>2</sup> dhe tokë bujqësore ullishtë me sip. 3.000 m<sup>2</sup>, për të cilën është pajisur me AMTP-në nr. \*\*\*, datë 6.3.1993. Po ashtu, u provua fakti se familja bujqësore me kryefamiljar babain e subjektit të rivlerësimit ka përfituar tokë bujqësore, në përdorim, sipas ligjit nr. 7501/1991, “Për tokën”, në fshatin A, për të cilën është pajisur me AMTP-në nr. \*\*\* akti, datë 11.10.1994. Gjithashtu u provua se sipas vërtetimit datë 20.10.2016, të Njësisë Administrative N, babai i subjektit të rivlerësimit ka përfituar pasurinë në përdorim si punëtor i ish-NB/A.

**25.29** Në vijim u konstatua se Njësia Administrative N<sup>67</sup> konfirmon pronësinë e tokës bujqësore, si dhe të sipërfaqes në përdorim nga familja bujqësore që prej vitit 1993 e në vazhdim. Njëkohësisht nga dokumentacioni i administruar provohet edhe regjistrimi i ngastrave në regjistrat publikë<sup>68</sup> të sipërfaqes së tokës në pronësi.

**25.30** Sipas certifikatës<sup>69</sup> së gjendjes familjare datë 1.8.1991, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, në kohën e përfitimit të këtyre pasurive, ka qenë anëtare e trungut familjar dhe, për rrjedhojë, ajo është bashkëpronare e familjes bujqësore.

---

<sup>65</sup> Me deklaratat noteriale të depozituara me pyetësorin nr. 2, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>66</sup> Referuar neneve 222 dhe 223 dhe në vijim të Kodit Civil.

<sup>67</sup> Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 1.7.2020, depozituar me pyetësorin nr. 2, datë 28.10.2022.

<sup>68</sup> Një kopje e certifikatës për vërtetim pronësie, tipi i pasurisë arë, data e regjistrimit 16.7.2018, nr. i pasurisë \*\*\*; një kopje e certifikatës për vërtetim pronësie, tipi i pasurisë arë, data e regjistrimit 16.7.2018, nr. i pasurisë \*\*\*; një kopje e certifikatës për vërtetim pronësie, tipi i pasurisë arë, data e regjistrimit 5.7.2022, nr. i pasurisë \*\*\*; një kopje e certifikatës për vërtetim pronësie, tipi i pasurisë arë, data e regjistrimit 4.3.2016, nr. i pasurisë \*\*\*; një kopje e certifikatës për vërtetim pronësie, tipi i pasurisë arë, data e regjistrimit 8.7.2019, nr. i pasurisë \*\*\*.

<sup>69</sup> Depozituar me pyetësorin nr. 2, datë 28.10.2022, administruar në dosjen e Komisionit.

**25.31** Lidhur me çështjen e ushtrimit të aktivitetit bujqësor, trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të administruar<sup>70</sup>, konstatoi se nga institucionet përkatëse konfirmohen të dhëna se: (i) kryefamiljari i familjes bujqësore rezultoi i regjistruar si fermer dhe tokën që ka në pronësi dhe përdorim e ka punuar gjithë kohës, ka paguar rregullisht detyrimet për tokën bujqësore dhe se nuk ka detyrime për të; (ii) nëna e subjektit të rivlerësimit ka qenë e vetëpunësuar në bujqësi dhe ka paguar rregullisht kontributet përkatëse nga viti 1993 deri në vitin 2022; (iii) familja bujqësore me kryefamiljar babain e subjektit ka në pronësi të saj \*\*\* rrënjë ullinj; (iv) Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Bashkia Vlorë, ka prezantuar një vlerësim mbi prodhimin mesatar për kultivarin kalinjot dhe kultivarin frantoil, sikurse rezultoi të jetë lloji i ullinjve të kësaj familjeje; (v) fermeri LL.K.M rezultoi i regjistruar në sistemin Ruda, sipas të cilit provohet se familja është marrë me veprimtarinë e mbarështimit të gjedhëve.

**25.32** Nga analiza e dokumentacionit të administruar u provua se familja bujqësore e subjektit të rivlerësimit ka banuar dhe banon<sup>71</sup> në fshatin M, ku dhe rezultoi të ketë pasurinë në pronësi të saj, e ndarë në arë, vresht dhe ullishtë.

**25.33** Në të tilla kushte dhe rrethana, trupi gjykues nuk krijoi dyshime lidhur me ekzistencën e pasurisë së familjes bujqësore të subjektit të rivlerësimit dhe konstatoi se nga hetimi identifikohen dhe administrohen mjaftueshëm të dhëna dhe fakte për ekzistencën e ushtrimit të aktivitetit bujqësor.

**25.34** Në lidhje me nivelin e provueshmërisë së të ardhurave të krijuara nga aktiviteti i familjes bujqësore, trupi gjykues për këtë çështje, në raport me shpjegimet dhe provat e depozituara nga subjekti i rivlerësimit në prapësime të rezultateve, konstatoi se nga ana e saj janë marrë të dhëna zyrtare përmes institucioneve përkatëse lidhur me përllogaritjet e të ardhurave dhe shpenzimeve nga aktiviteti bujqësor, ullahtat dhe prodhimtarinë e tyre.

**25.35** Në këtë drejtim, trupi gjykues vëren se Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural lidhur me kërkimin e subjektit për të përllogaritur të ardhurat dhe shpenzimet nga aktiviteti bujqësor, ullahtat, dhe blegtoral i familjes bujqësore me përfaqësues LL.M, ka informuar<sup>72</sup> se (i) *të dhënat janë statistike me burime administrative dhe nuk mund të përdoren si referencë për raste të veçanta;* (ii) *...të dhënat mbi të ardhurat dhe shpenzimet e kërkuesit mund të gjeneroheshin vetëm nga Rrjeti i të Dhënave të Kontabilitetit të Fermës (FADN), sistem i cili nuk është ngritur ende nga MBZHR-*

<sup>70</sup> Një kopje e vërtetimit për të vetëpunësuar në bujqësi në emër të znj. L.XH.M, lëshuar nga ISSH-ja Vlorë; një kopje e librezës së kontributeve të sigurimeve shoqërore të derdhura në emër të znj. L.XH.M; një kopje e vërtetimit nr. \*\*\*prot., datë 23.6.2020, lëshuar nga Njësia Administrative N, Drejtoria e Tatim-Taksave, nga e cila rezultoi se fermeri LL.K.M nuk ka detyrime për tokën bujqësore; një kopje e vërtetimit nr. \*\*\* prot., datë 12.6.2020, lëshuar nga Njësia Administrative N, Bashkia Vlorë, me të cilin provohet fakti se fermeri LL.K.M ka në pronësi \*\*\* rrënjë ullinj; një kopje e vërtetimit nr. \*\*\* prot., datë 1.7.2020, lëshuar nga Njësia Administrative N, Bashkia Vlorë, me të cilin provohet fakti se fermeri LL.K.M tokën që ka në pronësi dhe përdorim e ka punuar gjithë kohës dhe ka paguar rregullisht detyrimet për tokën; një kopje e vërtetimit datë 1.9.2020, lëshuar nga kryesia e fshatit M, Njësia Administrative N, Bashkia Vlorë, me të cilin provohet se fermeri LL.K.M ka në pronësi \*\*\* rrënjë ullinj; një kopje e certifikatës së regjistrimit të fermerit LL.K.M; një kopje të dhënave të printuara nga sistemi Ruda – Sistemi i Informacionit Blegtoral dhe Veterinar, pranë Drejtorisë Rajonale Veterinare dhe Mbrojtjes së Bimëve Vlorë, me të cilin provohet se fermeri LL.K.M është marrë me veprimtarinë e mbarështimit të gjedhëve; një kopje e shkresës me nr. \*\*\* prot., datë 6.12.2022, me lëndë “Vlerësim prodhimi në tokë të mbjellë me ullinj”, drejtuar shtetasit Armida Hamiti, lëshuar nga Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Bashkia Vlorë, mbi vlerësimin e prodhimit mesatar për kultivarin kalinjot dhe kultivarin frantoil; një kopje e vërtetimit me nr. \*\*\* prot., datë 10.7.2020, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve Vlorë, me të cilin vërtetohet se për periudhën 1993 – 2010 nuk rezultoi të ketë regjistër për numrin e krerëve të gjedhëve të familjeve bujqësore. Ky regjistër në Qarkun e Vlorës ka filluar të funksionojë pas vitit 2011; një kopje e vërtetimit nr. \*\*\* prot., datë 1.7.2020, mbi numrin e ullinjve që ka në pronësi fermeri LL.K.M.

<sup>71</sup> Sipas vërtetimit datë 20.10.2016, të Njësies Administrative N.

<sup>72</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.12.2022.

ja; dhe (iii) megjithatë të ardhurat për çdo fermë individuale nxirren vetëm bazuar në bilancin e të ardhurave dhe shpenzimeve për çdo vit të veçantë – si dhe ka vendosur në dispozicion disa botime shkencore mbi studimet e kulturave bujqësore, gjedhëve, prodhimtarinë etj.

**25.36** Po ashtu, edhe Instituti i Statistikave/INSTAT-i<sup>73</sup> ka dhënë informacion lidhur me çmimin e shitjes së ullirit për periudhën 1993 – 2016, ndërsa Institucioni i Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore Vlorë<sup>74</sup> ka informuar mbi prodhimtarinë e ullirit kalinjot (50-vjeçar), duke dhënë shifra konkrete në përfitime, si 80-100 kg për rrënjë, mbi vlerën e çmimit kokërr për vitet 1993 – 2016, e cila, sipas informacionit, varion nga 120-150 lekë/kg, si dhe mbi prodhimtarinë e ullirit frantoil, i futur në prodhim në vitin 1996, ku sipas këtij informacioni prodhimi varion nga 50-70 kg/rrënjë dhe, në këtë rast, kjo qendër jep të dhëna edhe mbi vlerën e çmimit kokërr për vitet 1993 – 2016, ku po sipas informacionit thuhet se varion 50-90 lekë/kg.

**25.37** Trupi gjykues konstaton se edhe këto institucione japin informacion se sa mund të rezultojnë të ardhurat e përfituara nga prodhimtaria e ullinjve. Në kushtet e mungesës së një dokumentacioni të plotë mbi masën reale të të ardhurave të përfituara nga shfrytëzimi i ullishtave, në çështjen objekt vlerësimi mbahet në konsideratë fakti se pronësia e babait të subjektit të rivlerësimit për \*\*\* rrënjë ullinj kaninjot shekullor, si dhe \*\*\* rrënjë frantoil është e provuar me AMTP-të përkatëse, si dhe me informacionin e dhënë nga Njësia Administrative N.

**25.38** Sa i përket përmbushjes së kërkesave të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, trupi gjykues çmon të drejtë qëndrimin e subjektit për këtë çështje, pasi nga analizimi i legjislacionit të zbatueshëm nuk evidenton dispozita ligjore që të kategorizojnë të ardhurat nga shfrytëzimi i ullishtave, si të ardhura të tatueshme. Detyrimi që prodhuesit e produkteve bujqësore, në këtë rast kultivuesit e ullirit, kanë kundrejt organeve shtetërore, janë taksat vendore për tokën bujqësore, të parashikuara nga neni 9, pika 2 e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Për të provuar shlyerjen e taksave vendore për tokën bujqësore, subjekti ka provuar me dokumentacion që në pyetësin nr. 2 se babai i saj ka paguar taksën e tokës bujqësore.

**25.39** Në këto rrethana, trupi gjykues vlerëson se duhen mbajtur në konsideratë përlllogaritjet e raportit të vlerësimit, përgatitur nga ekspertët, për të ardhurat nga ullishtat, pasi konstatohet se ai është mbështetur: (i) në informacionin e marrë nga burime zyrtare dhe jozyrtare, të cilat derivojnë nga të dhëna statistikore, manuale; (ii) në kuadrin ligjor dhe nënligjor; (iii) në literaturën e shumtë (botime shkencore të autorëve të ndryshëm); (iv) në moshën dhe gjendjen e ullishtave, burimet e informacionit të siguruara nga të dhënat statistikore të INSTAT-it të botuara *online*, bazuar në të dhënat studimore të autorëve të mirënjohur të zonës, në eksperiencat praktike dhe statistikave (vjetarët statistikorë të ministrisë) disavjeçare të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të aksesueshme në faqen *online* të saj, si dhe në informacionin<sup>75</sup> e Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore Vlorë.

**25.40** Konstatohet se pas përpunimit të të dhënave ekspertët kanë arritur në konkluzion se: (i) fitimi i periudhës 1994 – 2011 nga ulliri kalinjot është në vlerën 3.592.620 lekë; (ii) fitimi i periudhës 1996 – 2011 nga ulliri frantoil është në vlerën 9.118.368 lekë, në total 12.710.988 lekë të ardhura. Trupi gjykues vëren se ekspertët në përlllogaritjen e të ardhurave kanë përdorur çmime mesatare vjetore të ponderuara, si dhe sasi mesatare prodhimi të ponderuar. Vërehet se çmimet dhe sasi të mesatare të prodhimit, të përdorura nga ekspertët në raportin e tyre, janë më të ulëta sesa

<sup>73</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 9.12.2022.

<sup>74</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 6.12.2022.

<sup>75</sup> Referohuni shkresës nr. \*\*\* prot., datë 6.12.2022.

ato të vëna në dispozicion nga INSTAT-i apo nga Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Vlorë.

**25.41** Në përfundim, për sa arsyetuar më sipër, trupi gjykues vlerësoi të marrë në konsideratë të ardhurat e përfituara nga ullishtat, sipas llogaritjeve në raport-vlerësimin për të ardhurat nga ullishtat, pasi çmon se provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit mbi të ardhurat e familjes bujqësore në harmoni me njëra-tjetrën, por edhe referuar jurisprudencës së Kolegjit<sup>76</sup>, provojnë bindshëm që kjo familje ka përfituar në mënyrë të vazhdueshme dhe të pandërprerë të ardhura nga shfrytëzimi i ullishtave.

**25.42** Lidhur me të ardhurat e përfituara nga ushtrimi i aktivitetit blegtoral të familjes bujqësore të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se dokumentacioni i depozituar nga subjekti: (i) prej Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore Vlorë, e cila jep të dhëna në favor të kësaj familjeje nga blegtoria edhe para vitit 2010; (ii) për regjistrimin e fermerit në sistemin Ruda; apo (iii) referuar edhe fletëdaljeve nga regjistrat e vjetër të asaj kohe me firmë të veterinerit ose agronomit, ku pasqyrohen blerje produktesh (ure, pesticide, nitrate, etj.) për kulturat (jonxhë, misër dhe grurë) ose shërbime veterinarie që kanë shërbyer për gjedhët dhe shpendët, megjithëse pasqyron *indicie*/informacion rreth këtij aktiviteti – nuk krijon bindjen për vlerën reale të shumës së pretenduar nga subjekti, si dhe të pasqyruar nga ekspertët dhe, për rrjedhojë, nuk merren në konsideratë.

**25.43** Trupi gjykues, pavarësisht faktit të moskonsiderimit të të ardhurave të pretenduara nga aktiviteti blegtoral i familjes së saj lidhur me shpenzimet e jetesës së kësaj familjeje, konstaton se gjatë hetimit u provua se babai i subjektit të rivlerësimit ka përfituar të ardhura nga pagat për periudhën 1994 – 2011 në shumën 2.409.206 lekë dhe nëna e subjektit ka paguar kontributet e sigurimeve shoqërore e vetëdeklaruar si e punësuar në bujqësi për periudhën 1993 – 2022. Në këtë drejtim, trupi gjykues, nisur nga fakti se veprimtaria dhe jetesa e familjes bujqësore e përditshme zhvillohet dhe është e lidhur pazgjidhshmërisht me jetesën në zonën rurale në të cilën kanë pasur dhe kanë edhe aktualisht tokën bujqësore në pronësi e përdorim, si dhe referuar jurisprudencës së Kolegjit<sup>77</sup>, sipas të cilit kostoja e jetesës është më e ulët sesa në qytet, vlerëson se këto të ardhura mund të kenë shërbyer për mbulimin e shpenzimeve të jetesës.

**25.44** Në përfundim, trupi gjykues, për këto pasuri, çmon se nuk ka rrethana të tilla që mund të cenojnë kriterin e vlerësimit të pasurisë apo procesin në tërësi të rivlerësimit të subjektit. Në konkluzionin përfundimtar trupi gjykues është bazuar thelbësisht në aplikimin e parimit të proporcionalitetit, duke vënë në balancë rrethanat e konstatuara të lidhura me pasuri të krijuara para detyre, në mungesë të kontributit financiar nga subjekti, si dhe në mosevidentimin e ndonjë rrethane tjetër për deklaram të rremë, fshehje pasurie apo që të ardhurat të jenë rrjedhojë e ndonjë veprimtarie të kundërligjshme që mund të cenonte pozitën e saj në këtë proces. Për sa u arsyetua më sipër, ligjshmëria e të ardhurave për pasuritë e krijuara para fillimit të detyrës së subjektit dhe në nivelin e provave dhe rrethanave specifike të rezultuara për këtë subjekt, vlerësohen nga trupi gjykues se nuk cenojnë qëllimin e ligjit që normon procesin e rivlerësimit kalimtar. Ky konkluzion i trupit gjykues, parë nën dritën e parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, është në koherencë edhe me vendimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) S vs Albania, ku në paragrafin 96, citohet: “...gjykata vlerëson se në bazë të një vlerësimi të përgjithshëm të rrethanave të veçanta të çështjes, shkarkimi i kërkueses, bazuar në thelb në faktin se ajo nuk ishte në gjendje

<sup>76</sup> Referuar Vendimit nr. \*\*\*, datë 14.6.2022, i Kolegjit.

<sup>77</sup> Referuar vendimit nr. \*\*\*, datë 8.06.2022.

*të provonte se burri i saj kishte paguar tatimin mbi disa nga të ardhurat e tij nga aktivitetet e ligjshme në dy dekadat e mëparshme dhe në mungesë të ndonjë treguesi për keqbesim ose shkelje të qëllimshme nga vetë aplikanti, ishin në disproporcion me qëllimet legjitime të ndjekura nga procesi i verifikimit”.*

**26. Të ardhura të përfituara nga shitja e automjetit tip “Peugeot”,** me numër shasie \*\*\*, nëpërmjet kontratës së shitjes nr. \*\*\*, datë 22.11.2015, në vlerën 1.000 euro, i cili është blerë me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 21.11.2012, në vlerën 100.000 lekë, me të ardhura nga paga. Pjesa takuese: 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën disa dokumente<sup>78</sup>.

**26.1** Nga hetimi rezultoi se subjekti i rivlerësimit e deklaroi për herë të parë blerjen e automjetit në deklaratën e interesave privatë periodikë vjetorë për vitin 2012, me përshkrimin “Në datën 21.12.2012, blerje automjeti tip ‘Peugeot’ (viti 2000), nga shtetasja shqiptare A.SH, banuese në Fier, me të ardhura nga puna. Vlera: 100.000 lekë”.

**26.2** Ndërsa, në deklaratën e interesave privatë periodikë vjetorë për vitin 2015, subjekti deklaroi shitjen e këtij automjeti me përshkrimin “Shitje automjeti tip ‘Peugeot’, me targa \*\*\*, nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*, datë 22.10.2015. Vlera: 1.000 euro”.

**26.3** Komisioni e ka pyetur<sup>79</sup> subjektin nëse është paguar tatim mbi të ardhurat e përfituara nga diferenca e shumës nga blerja e automjetit dhe shitja e tij. Subjekti, në përgjigjen e dhënë, ka deklaruar: “...nuk është paguar tatim mbi të ardhurat e përfituara nga diferenca e shumës, blerja dhe më pas shitja e automjetit tip ‘Peugeot’, me nr. shasie \*\*\*, për shkak se në dijeninë time nuk është një e ardhur, e cila konsiderohet e tatueshme në kuptim të nenit 8 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, ‘Për tatimin mbi të ardhurat’, i ndryshuar, si dhe udhëzimit nr. 5, datë 30.1.2006, ‘Për tatimin mbi të ardhurat’, i ndryshuar. Kjo e ardhur nuk renditet në asnjë prej të ardhurave për të cilat paguhet tatimi. Duke parë edhe diferencën midis çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes, e cila është relativisht e vogël, nuk i kam kushtuar vëmendjen e duhur rastit”.

**26.4** Komisioni në analizën e kryer ka përfshirë në zërin “të ardhura” vetëm vlerën 100.000 lekë, që korrespondon me vlerën e shpenzuar për blerjen e automjetit.

**27. Automjet tip “Golf Volkswagen”,** me nr. shasie \*\*\*, blerë me kontratën e shitjes datë 10.12.2015, nga shtetasi francez P.H (banues në \*\*\*, Francë), me vlerë 1.450 euro. Ky automjet është blerë me të ardhurat e siguruar nga shitja e automjetit tip “Peugeot”, me targa \*\*\*, në vlerën 1.000 euro dhe pjesa tjetër me të ardhura nga paga. Pjesa takuese: 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën kontratën e blerjes datë 10.12.2015, me palë shitëse P.H dhe palë blerëse Armida Hamiti për blerje automjeti tip “Golf”, me vlerë 1.450 euro<sup>80</sup>.

## **Hetimi i Komisionit**

**27.1** Subjekti i rivlerësimit e deklaroi për herë të parë blerjen e këtij automjeti në deklaratën e interesave privatë periodikë vjetorë për vitin 2015, me përshkrimin “Blerje automjeti i tipit ‘Volkswagen’ në shtetin gjerman, nëpërmjet kontratës së blerjes datë 10.12.2015 (ky automjet

<sup>78</sup> Kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 21.11.2012, me palë shitëse A.SH dhe palë blerëse Armida Moçka për blerje automjeti tip “Peugeot”, vlera 100.000 lekë; kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 22.10.2015, me palë shitëse Armida Moçka dhe palë blerëse F.SH për shitje automjeti tip “Peugeot”, vlera 1.000 euro; certifikatë pronësie të automjetit tip “Peugeot”, në emër të znj. Armida Hamiti, me targa \*\*\*. Aneks nr. \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>79</sup> Me pyetësorin nr. 2, datë 28.10.2022.

<sup>80</sup> Aneks nr. \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.

është blerë nga të ardhurat e realizuara nga shitja e automjetit tip ‘Peugeot’, me targa \*\*\* dhe pjesa tjetër nga të ardhurat nga paga). Vlera: 1.450 euro”.

**27.2** DPSHTRR-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.8.2020, informon se shtetasja Armida LL. Hamiti aktualisht ka të regjistruar automjetin me targa \*\*\*. Ky institucion ka depozituar dosjen e automjetit, ku konfirmohet blerja e tij në datën 10.12.2015, në vlerën 1.450 euro. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar rezultoi se ky automjet është zhdoganuar në datën 31.12.2015, në vlerën 84.680 lekë.

**27.3** Komisioni kreu analizën financiare për të verifikuar mundësitë financiare të subjektit të rivlerësimit për të investuar në blerjen e këtij automjeti (sikurse pasqyrohet në tabelën e mëposhtme) dhe nuk i rezultuan problematika. Në analizë, shpenzimet e jetesës janë përllogaritur sipas deklaramit të subjektit dhe bashkëshortit të saj se pagat e përfituara nga bashkëshortët janë shpenzuar, duke zbritur investimin, kursimet *cash* prej 200.000 lekësh dhe gjendjen në bankë.

**Tabela nr. 4**

Nr.	Përshkrimi	Viti 2015
<b>1</b>	<b>TË ARDHURA</b>	<b>2,142,849</b>
	Të ardhura nga paga, subjekti	1,004,049
	Të ardhura nga paga, bashkëshorti	1,030,636
	Të ardhura nga interesat	8,164
	Të ardhura nga shitja e automjetit tip “Peugeot”, me targa *** (datë 22.10.2015)	100,000
<b>2</b>	<b>SHPENZIME</b>	<b>9,057,076</b>
	Shpenzime jetese sipas deklaramit të subjektit dhe bashkëshortit	1,629,900
	Transferuar shuma e depozitave te nëna	7,427,175
<b>3</b>	<b>PASURI</b>	<b>(7,027,616)</b>
	<b>Pasuri e paluajtshme/e luajtshme</b>	
	Blerje automjeti tip “Volkswagen”, datë 10.12.2015, me targa ***	200,318
	<i>Ndryshim likuiditeti</i>	(7,227,933)
	<b>DIFERENCA (1-2-3)</b>	<b>113,389</b>

**28. Gjendje e llogarisë së pagës, datë 18.1.2017, në vlerën 0,64 lekë.** Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës konfirmimin nr. \*\*\* prot., datë 18.1.2017, nga “Credins Bank”, sipas të cilit balanca e llogarisë së shtetasës Armida Hamiti është në vlerën 0,64 lekë<sup>81</sup>.

**28.1** “Credins Bank”, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 6.11.2020, informon se shtetasja Armida Hamiti ka llogari me gjendje 0,64 lekë, në datën 25.1.2017 (datën e dorëzimit të deklaratës *Vetting*).

**28.2** Për sa më sipër, trupi gjykues konstatoi se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e “Credins Bank”.

#### **Deklarimi i pasurive të bashkëshortit të subjektit, z. G.H**

**29. Të ardhura të përfituara nga ushtrimi i aktivitetit tregtar “\*\*\*”, me pjesëtar të familjes (vëllain) përpara vitit 2005, në vlerën 500.000 lekë, shumë e cila është konsumuar ndër vite.** Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: ekstraktin historik datë 12.10.2016, për personin fizik “F.H”,

<sup>81</sup> Aneks nr. \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.



datë regjistrimi 2.2.1998, me vendndodhje Delvinë, objekti “\*\*\*”; vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 12.10.2016, të Bashkisë Delvinë, sipas të cilit personi fizik “F.H”, me NIPT \*\*\*, ka filluar veprimtarinë e biznesit në datën 15.2.1998 dhe ka likuiduar detyrimet tatimore të pushtetit lokal në mënyrë të rregullt për çdo vit<sup>82</sup>.

**30. Të ardhura të përfituara nga shitja e truallit me sip. 300 m<sup>2</sup>**, sipas kontratës së shitjes nr. \*\*\*, datë 11.2.2008, në vlerën 800.000 lekë. Pjesa takuese: 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente<sup>83</sup>.

**30.1** Në DPV/2004 bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar: *“Në emrin tim ekziston një sipërfaqe truall prej 300 m<sup>2</sup>, mbi të cilën është ndërtuar një godinë 5-katëshe, por në të vërtet është e vëllait tim dhe djalit të xhaxhait, të cilët do ta hedhin në emrin e tyre në momentin e hipotekimit të objektit. Ky truall është blerë nga zyra e përmbarimit e rrethit Sarandë, ku ekziston edhe kontrata e shitjes. Vlera: 215.000 lekë. Pjesa që zotëroj: 0%. Data e krijimit të pasurisë, dhjetor 2002”*.

**30.2** Në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës (emërimi datë 5.10.2007) bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar: *“Gjendje cash e përfituar prej shitjes së një truall, kontrata shitblerjeje, si dhe nga aktiviteti biznesi i vogël ‘\*\*\*’, ushtruar me pjesëtar të familjes (vëllain). Vlera: 1.300.000 lekë”*.

**30.3** Në kushtet kur bashkëshorti i subjektit është gjithashtu subjekt deklarues, Komisioni<sup>84</sup> vlerësoi se hetimi dhe analizimi për këto të ardhura do të kryhet nga një tjetër trup gjykues sepse këto deklarime korrespondojnë me periudhën përpara martesës dhe bashkëjetesës me subjektin e rivlerësimit Armida Hamiti dhe për faktin se nuk u evidentuan lidhje të subjektit me këto të ardhura.

**31. Të ardhura të përfituara nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz”** (viti 2002), me kontratën e shitjes nr. \*\*\*, datë 10.2.2016, me vlerë 3.000 euro, blerë në datën 7.3.2012, në shumën 3.500 euro nga shtetasja italiane E.T [banuese në Campodoro \*\*\* Itali] me të ardhura të disponueshme para fillimit të detyrës. Pjesa takuese: 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente<sup>85</sup>.

## Hetim i Komisionit

**31.1** Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit e deklaroi për herë të parë blerjen e këtij automjeti në deklaratën e interesave privatë periodikë vjetorë për vitin 2012, me përshkrimin “Më datë 7.3.2012, blerje automjeti tip ‘Mercedes-Benz’ (viti 2002) nga shtetasja italiane E.T, banuese në Campodoro \*\*\*, Itali. Burimi i krijimit: të ardhura të disponueshme para fillimit të detyrës. Vlera: 3.500 euro”.

**31.2** Ndërsa në deklaratën e interesave privatë periodikë vjetorë për vitin 2016, bashkëshorti i subjektit deklaroi shitjen e këtij automjeti me përshkrimin “Të ardhura të përfituara nga shitja e

<sup>82</sup> Aneks nr. \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>83</sup> Kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 20.12.2002, me palë shitëse Zyra e Përmbarimit Sarandë dhe palë blerëse G.H, për blerje truall me sip. 300 m<sup>2</sup>, në Delvinë, vlera 215.000 lekë; vërtetim hipotekor nr. \*\*\*, datë 11.3.2004, për truall me sip. 300 m<sup>2</sup>, Delvinë, në pronësi të z. G.H +hartë treguese; kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 11.2.2008, me palë shitëse G.H dhe palë blerëse A.H dhe F.H për shitje truall me sip. 300 m<sup>2</sup>, Delvinë, vlera 800.000 lekë. Aneks nr.\*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>84</sup> Referuar vendimit nr. \*\*\*, datë 21.1.2019, të Komisionit.

<sup>85</sup> Deklaratë datë 7.3.2012 e shtetasit E.T, e cila deklaroi se i ka shitur shtetasit G.H automjetin tip “Mercedes-Benz E270 CDI”, në vlerën 3.500 euro; kontratë shitjeje automjeti nr. \*\*\*, datë 10.2.2016, me palë shitëse G.H dhe palë blerëse O.C, për shitje automjeti tip “Mercedes-Benz”, me targa \*\*\*, në vlerën 3.000 euro. Aneks nr. \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.

automjetit tip ‘Mercedes-Benz’ (viti 2002) nëpërmjet kontratës së shitjes nr.\*\*\*, datë 10.2.2016. Vlera: 3.000 euro”.

**31.3** DPSHTRR-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.8.2020, informon se shtetasi G.O.H ka pasur të regjistruar automjetin me targa \*\*\*. Ky institucion ka depozituar dosjen e automjetit, nga ku konfirmohet blerja e tij më 7.3.2012. Automjeti rezultoi se është zhdoganuar në datën 12.3.2012 dhe vlera e paguar për zhdoganim ka qenë 150.012 lekë.

**31.4** Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar rezultoi se automjeti është shitur në datën 10.2.2016 sipas kontratës së shitjes nr. 149/87, në vlerën 3.000 euro, me palë shitëse G.O.H dhe palë blerëse O.G.C.

**31.5** Meqenëse në vitin 2012 bashkëshortët rezultojnë të lidhur me njëri-tjetrin, të ardhurat dhe shpenzimet për bashkëshortin e subjektit janë përfshirë në analizën financiare që prej këtij viti. Nga analiza financiare e kryer për vitin 2012 nuk rezultuan balanca negative, çka provon se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka pasur aftësi pagueuse të ligjshme për blerjen e këtij automjeti. Ndërsa, të ardhurat e përfituara nga shitja e këtij automjeti janë përfshirë në analizën financiare për vitin 2016, nga ku nuk kanë rezultuar problematika.

**32. Apartament me sip. 109,5 m<sup>2</sup>, marrë me qira me kontratën e qiradhënies nr. \*\*\***, të ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, me çmim të qirasë 20.000 lekë/muaj. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës kontratën e qirasë<sup>86</sup> nr. \*\*\*, datë 18.1.2017, me palë qiradhënëse A.M dhe palë qiramarrëse G.H, për marrje me qira të apartamentit me sip. 109,5 m<sup>2</sup>, në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, me afat 2-vjeçar. Vlera e qirasë: 20.000 lekë/muaj.

**32.1** Subjekti i rivlerësimit është pyetur<sup>87</sup> se më çfarë titulli ka qëndruar në këtë apartament përpara lidhjes së kontratës së qirasë dhe, në përgjigjen e dhënë, ka deklaruar se ka qëndruar me kontratë qiraje verbale.

**32.2** Subjekti i rivlerësimit ka depozituar kontratën e sipërmarrjes datë 15.5.2002, nga verifikimi i së cilës rezultoi se është nënshkruar për porosinë dhe blerjen e kësaj pasurie nga shtetasi A.M, në cilësinë e porositesit të apartamentit, dhe L.S. Subjekti ka depozituar kontratën e shitjes së pasurisë nr. \*\*\*, datë 8.7.2020, së bashku me kartelën e pasurisë, ku konfirmohet shitblerja e pasurisë me nr. \*\*\*. Kontrata e shitblerjes së pasurisë së dhënë me qira rezulton e nënshkruar ndërmjet bashkëshortëve A dhe E.M dhe shtetasit L.S, në cilësinë e shitësit. Pasuria e dhënë me qira përkon me atë të përcaktuar në kontratën e shitjes, pasi në kontratën e qirasë qartësohet fakti se ajo/pasuria ka qenë ende e pahipotekuar, porse në përmbajtje të saj saktësohet se jepet me qira pasuria e përshkruar sipas kontratës së sipërmarrjes, nënshkruar në datën 15.5.2002. Njëkohësisht subjekti ka depozituar edhe certifikatën e pronësisë lidhur me origjinën e kësaj pasurie, e lëshuar në datën 8.1.2020, në emër të shitësit L.S dhe në datën 21.10.2020, në emër të bashkëshortëve E dhe A.M.

**32.3** ASHK-ja<sup>88</sup> dhe noteri<sup>89</sup> kanë depozituar praktikën e kontratës së shitjes nr. \*\*\*, datë 8.7.2020 dhe regjistrimit të kësaj pasurie në emrin e shtetasit A.M.

**32.4** Subjektit i është kërkuar<sup>90</sup> të depozitojë kontratën e shërbimit me energji elektrike dhe kontratën e shërbimit të ujësjellësit, si dhe të deklarojë se nga kush kryhen pagesat për këta

<sup>86</sup> Aneks nr. \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>87</sup> Me pyetësin nr. 2, datë 28.10.2022.

<sup>88</sup> Me email-in e datës 1.12.2022.

<sup>89</sup> Në përgjigjen datë 22.11.2022.

<sup>90</sup> Me pyetësin nr. 3, datë 10.11.2022, administruar në dosjen e Komisionit.

operatorë. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigjen e dhënë, ka deklaruar “*Faturat e konsumimit të energjisë elektrike, si dhe të konsumimit të ujit të banesës, në të cilën jetojmë me qira, i paguajmë ne, në cilësinë e qiramarrësit*” dhe, ndërkohë, ka depozituar një kopje të librezës së dritave dhe të ujit për periudhën kohore nga momenti kur kanë nisur të jetojnë me qira në këtë apartament. Nga dokumentacioni i depozituar nga subjekti vërehet se librezat e UKT-së është në emër të shtetasit A.M prej vitit 2014, ndërsa librezat e FSHU-së është në emër të shtetasit L.S.

**32.5** Në lidhje me ekzistencën e ndonjë konflikti të mundshëm interesi të subjektit dhe bashkëshortit me qiradhënësin, shtetasin A.M, për shkak të funksionit, subjekti ka deklaruar se asnjëri prej tyre nuk ka hetuar apo gjykuar çështje me këtë person dhe në funksion të këtij deklarimi ka depozituar vërtetimet<sup>91</sup> përkatëse nga institucionet punëdhënëse për secilin.

**32.6** Trupi gjykues, në analizë të përgjigjes së dhënë dhe dokumentacionit të administruar, nuk konfirmoi të dhëna për të konkluduar në ndonjë konflikt të mundshëm interesi midis subjektit të rivlerësimit, bashkëshortit të saj dhe qiradhënësit.

**32.7** Gjithashtu, Komisioni e ka pyetur<sup>92</sup> subjektin në lidhje me hetimin e ndonjë çështjeje ndaj/nga shtetasi L.S, në cilësinë e shitësit të kësaj pasurie, për shkak se apartamenti i marrë me qira rezultoi sipas kartelës së pasurisë i regjistruar që prej vitit 2007, në emër të shitësit dhe se kontrata e shitjes me shtetasin A.M është realizuar në vitin 2020. Subjekti ka deklaruar dhe njëkohësisht ka depozituar dokumentacion<sup>93</sup>.

**32.8** Trupi gjykues, në analizë të përgjigjes së dhënë dhe dokumentacionit të administruar, nuk konfirmoi të dhëna për të konkluduar në ndonjë konflikt të mundshëm interesi midis subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit L.S.

**32.9** Lidhur me vlerën e qirasë rezultoi se sipas VKM-së Nr. 469, datë 3.6.2015, vlera e qirasë përlllogarit në masën 0,3% të vlerës së shitjes së apartamentit, përcaktuar në udhëzimin e Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banësive”.

**32.9.i** Rezultoi se apartamenti i marrë me qira nga bashkëshorti i subjektit ndodhet në Tiranë, në zonën 5/2, ku sipas Udhëzimit nr. 3, datë 28.12.2016, të Kryeministrit, vlera e shitjes së apartamenteve është 132.000 lekë/m<sup>2</sup>. Sipas këtyre referimeve, vlera e qirasë së apartamentit do të ishte: 109,5 m<sup>2</sup> x 132.000 lekë/m<sup>2</sup> x 0,3% = 43.362 lekë.

**32.9.ii** Për sa më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit të shpjegojë lidhur me vlerën e qirasë së paguar nga bashkëshorti, në raport me çmimet referuese të sipërcituara, pasi dukej se kishte trajtim preferencial.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**32.10** Subjekti, në prapësime lidhur me këtë çështje, ka sqaruar se në kohën e marrjes me qira këtë apartament nga bashkëshorti i saj në nëntor të vitit 2013 nuk ka pasur asnjë akt ligjor apo nënligjor që të detyronte palët të lidhnin kontratë qiraje me një çmim të caktuar duke përcaktuar tavanin apo

---

<sup>91</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 1.11.2022, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe shkresë nr. \*\*\* prot., datë 3.11.2022, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 17.11.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 16.11.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 16.11.2022, e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>92</sup> Pyetësor nr. 4, datë 15.11.2022, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>93</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 17.11.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 16.11.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, administruar në dosjen e Komisionit.

dyshtimet e tij. Subjekti ka qartësuar se edhe aktualisht nuk ekziston asnjë akt ligjor dhe nënligjor që të detyrojë qiradhënësin dhe qiramarrësin që të caktojnë një çmim të përcaktuar, pasi ky fakt do të binte ndesh me nenin 11 të Kushtetutës (parimi i lirisë së veprimtarisë ekonomike) dhe parimin e lirisë kontraktore të parashikuar në Kodin Civil (nenet 659, 801 dhe 803 të Kodit Civil)<sup>94</sup>.

**32.11** Subjekti ka shpjeguar se sipas nenit 803 të Kodit Civil, në rast se kontrata e qirasë lidhet për një periudhë më tepër se një vit, ajo bëhet me shkresë dhe se në referim të kësaj dispozite, kontrata e qirasë është ripërtëritur në formë verbale për çdo vit, deri në janar të vitit 2017. Subjekti ka deklaruar se kjo kontratë është formalizuar nëpërmjet kontratës së qirasë me nr. \*\*\*, datë 18.1.2017, pas insistimit të tyre të qiradhënësi, me qëllim për të bërë të mundur transferimin e vendbanimit dhe gjendjes civile pranë Bashkisë Tiranë, pasi ka qenë kusht që transferimi mund të bëhej nëse disponohej një titull pronësie mbi një banesë apo kontratë qiraje për një banesë/apartament. Ky fakt, ka deklaruar subjekti, vërtetohet lehtësisht edhe në regjistrat e gjendjes civile, për sa i përket datës së transferimit të gjendjes civile pranë Njësisë Administrative Nr. \*\*\*, Bashkia Tiranë. Ky transferim ka qenë i domosdoshëm me qëllim përmbushjen e detyrimeve, të cilat burojnë nga ligji nr. 10129/2009, “Për gjendjen civile”, si dhe për efekt të regjistrimit në shkollë të fëmijëve.

**32.12** Subjekti ka dhënë shpjegime në lidhje me zbatimin e vendimit nr. 469, datë 3.6.2015, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirasë së ndërtesave për qëllime tatimore”, duke theksuar se ky vendim është miratuar për qëllime tatimore kundrejt qiradhënësit, duke përcaktuar formulën dhe çmimet e referencës për efekt të llogaritjes së tatimit mbi të ardhurat personale nga qiraja, sipas gremës “d” të pikës 1 të nenit 8 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, në të cilin parashikohet: “1. Për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale merren si të ardhura të tatueshme: ...d) të ardhurat nga enfiteoza, huaja dhe qiratë, me përjashtim të rasteve, kur të ardhurat janë realizuar nga zhvillimi i një veprimtarie tregtare, në kuptim të legjislacionit tregtar ...”, ashtu siç përcaktohen çmime reference edhe për kontratat e shitjes, me qëllim llogaritjen e tatimit mbi të ardhurat nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme, sipas gremës “dh” të pikës 1 të nenit 8 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, në të cilin parashikohet: “1. Për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale merren si të ardhura të tatueshme: dh) të ardhurat nga kalimi i të drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme”.

**32.13** Subjekti ka sqaruar se VKM-ja është burim detyrimesh për qiradhënësin dhe jo qiramarrësin dhe se këto detyrime janë të natyrës tatimore, siç edhe është parashikuar<sup>95</sup> në pikat 5 dhe 6 të këtij akti nënligjor.

<sup>94</sup> Në të cilët gjenden këto parashikime: neni 11 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë: “1. Sistemi ekonomik i Republikës së Shqipërisë bazohet në pronën private e publike, si dhe në ekonominë e tregut dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike. 2. Prona private dhe publike mbrohen njëjloj me ligj. 3. Kufizime të lirisë së veprimtarisë ekonomike mund të vendosen vetëm me ligj dhe vetëm për arsye të rëndësishme publike”. Nenet 659, 801 dhe 803 të Kodit Civil kanë këto parashikime: “Neni 659, Kontrata është veprimi juridik me anë të së cilës një ose disa palë krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike. Neni 801 Qiraja është kontrata me të cilën njëra palë (qiradhënësi) detyrohet t’i japë palës tjetër (qiramarrësit) një send të caktuar, në gëzim të përkohshëm kundrejt një shpërblimi të caktuar. Neni 802 Qiradhënësi duhet: 1. t’i dorëzojë qiramarrësit sendin në kohën e caktuar dhe në gjendje që të lejojë përdorimin për të cilën palët janë marrë vesh; 2. të kujdeset për të mbajtur sendin në po këtë gjendje; 3. të garantojë gëzimin e qetë gjatë periudhës së qirasë. Neni 803 Kontrata e qirasë, për një kohë më të gjatë se një vit, duhet bërë me shkresë”.

<sup>95</sup> “5. Noterët të dërgojnë në Drejtoritë Rajonale Tatimore përkatëse, brenda datës 15.7.2015, listën e kontratave të qirave në fuqi, të lidhura ndërmjet personave të ndryshëm, pavarësisht nga statusi i tyre. Në vijim, lista e kontratave të qirasë, të lidhura gjatë çdo muaji, të dërgohet nga zyrat e noterive, brenda datës 5, të muajit pasardhës, në Drejtoritë Rajonale Tatimore përkatëse. Në çdo rast, lista e kontratave të qirave të përmbajë numrin e kontratës së lidhur, datën e lidhjes, emrin e qiradhënësit dhe numrin e

**32.14** Subjekti në shpjegimet e saj ka theksuar se çmimi i qirasë ka qenë vullnet mes palëve kontraktore, vullnet i cili nuk ka qenë i ndikuar nga asnjë rrethanë tjetër, përveçse kohës së gjatë që ka kaluar nga momenti që është lidhur, pasi aktualisht është hyrë në vitin e 10-të, faktit që kanë qenë qiramarrës të rregullt dhe e kanë mirëmbajtur këtë apartament – në kuptimin që mobilieve dhe pajisjeve të tjera elektrike nuk iu është shkaktuar asnjë dëmtim – faktit që kjo banesë ndodhet në një pallat të ndërtuar në vitin 2002, pra nuk është një ndërtim i ri, faktit që kjo banesë ka një mobilim modest, i cili nuk ka ndryshuar që nga momenti që e kanë marrë me qira dhe deri sot.

**32.15** Subjekti ka sqaruar edhe pozicionimin gjeografik të apartamentit. Më konkretisht, ka theksuar se për faktin e pozicionimit gjeografik, në të cilin ndodhet kjo banesë në kuptim të dritësimit dhe ngrohjes natyrale nga drita e diellit, ku drita natyrale (ka shpjeguar subjekti) pothuajse nuk bie fare mbi këtë apartament për shkak të pozicionit Veri, pra është një apartament i ftohtë, si dhe të qenët në katin e tretë.

**32.16** Subjekti ka deklaruar se në vlerën e qirasë ka ndikuar edhe sistemi termoizolues, ai elektrik, elektroshtëpiaket, si dhe sistemi i ngrohjes, të cilat janë të një cilësie nën mesataren në drejtim të kursimit të energjisë. Subjekti ka theksuar se ky fakt provohet lehtësisht edhe nga faturat e konsumit të energjisë elektrike, ndër vite, në të cilat evidentohet fakti i konsumit të lartë të energjisë elektrike sidomos në stinën e dimrit, ku konsumi mujor ka shkuar edhe në shumën 18.000 lekë, fakt i cili rezulton edhe nga librezat e energjisë elektrike.

**32.17** Subjekti ka sqaruar edhe zonën ku është pozicionuar ky apartament. Ajo ka evidentuar faktin se ky apartament nuk ndodhet në ndonjë kompleks të kërkueshëm, siç mund të jetë i ashtuquajturit “\*\*\*”, pallatet në hyrje të liqenit artificial apo pallatet e reja të ndodhura në Rrugën e \*\*\*, Tiranë. Gjithashtu ka shpjeguar se nëse do t’i referohet çmimit të shitjes së apartamentit, nëpërmjet kontratës së sipërmarrjes të vitit 2002, si dhe vlerës totale të qirasë të paguar prej tyre ndër vite, konstatohet fakti se qiradhënësi ka realizuar të ardhura nga kjo qira, të cilat në total janë më tepër se gjysma e vlerës së çmimit të shitjes së këtij apartamenti dhe, në këtë kuptim, subjekti thekson se nuk ka arsye që të duket e ulët.

**32.18** Subjekti ka parashtruar edhe nën argumentin e shkallës hierarkike të legjislacionit ku, si rrjedhojë, zbatimi i parimit të lirisë kontraktore i parashikuar në nenin 659 të Kodit Civil, në rastin konkret do të ketë epërsi zbatimi në raport me parashikimet e VKM-së Nr. 469, datë 3.6.2015.

**32.19** Subjekti ka theksuar edhe faktin se nga hetimi i Komisionit bashkëshortët nuk kanë rezultuar në konflikt interesi me qiradhënësin apo edhe faktin se pagat, që marrin së bashku me bashkëshortin, ua mundësojnë dhe pagimin e një qiraje më të lartë, çka do të thotë se nuk ka arsye apo motiv për të menduar për një vlerë qiraje fiktive. Subjekti ka depozituar foto të apartamentit në të cilin banojnë me qira.

**32.20** Në përfundim të prapësimeve të saj për këtë çështje, subjekti është shprehur se duke qenë se nuk ka asnjë të dhënë që të vërtetojë se çmimi i qirasë të jetë trajtuar në mënyrë preferenciale, për shkak të ushtrimit të detyrës së saj si prokurore dhe detyrës së bashkëshortit si gjyqtar dhe se çmimi i qirasë ka qenë për shkak të marrëveshjes me vullnet të lirë të palëve në kontratë, të përjashtohet prej Komisionit dyshimi se vlera e qirasë ka dyshime të kishte trajtim preferencial.

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

---

*tij të identifikimit, emrin e qiramarrësit dhe numrin e tij të identifikimit, vlerën mujore të qirasë dhe afatin e kontratës. 6. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për zbatimin e këtij vendimi”.*

**32.21** Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të dhëna, si dhe dokumentacionit të administruar, në këtë çështje objekt vlerësimi, arsyeton:

**32.22** Nga hetimi u konstatua se subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar rregullisht apartamentin e marrë me qira, si dhe vlerën e qirasë, marrëdhënie kjo e formalizuar me kontratë noteriale në vitin 2017 në të njëjtën vlerë.

**32.23** Ndërkohë, sipas dokumentacionit të administruar vërehet se: (i) ndërtimi i pallatit sipas kontratës së sipërmarrjes daton prej vitit 2002; (ii) subjekti pretendoi për pozicionimin gjeografik, në të cilin ndodhet kjo banesë, jo të favorshëm në kuptim të dritësimit dhe ngrohjes natyrale nga drita e diellit, duke depozituar gjithashtu edhe faturimet e larta të energjisë elektrike, si dhe foto të ambientit.

**32.24** Nga ana tjetër, trupi gjykues konstaton se në referim të kohës kur bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka marrë me qira këtë apartament, prej nëntorit të vitit 2013 dhe, më tej, është bashkuar edhe subjekti i rivlerësimit prej vitit 2015<sup>96</sup>, nuk ka ekzistuar akti nënligjor, i cili ka synuar përcaktimin e tatimit në varësi të të ardhurave të krijuara nga qiradhënësi dhe se tatimi sipas aktit i përket qiradhënësit, pavarësisht vullnetit të palëve.

**32.25** Trupi gjykues, në këtë çështje objekt vlerësimi, mbi trajtimin e mundshëm preferencial, në raport me rrethanat konstatuese, për sa arsyetoi më sipër, çmon se nuk mund të konkludojë për çmime fikse të qirasë në zonën ku ndodhet apartamenti, pasi ato lidhen edhe me vullnetin e palëve dhe në mungesë të ndonjë konflikti të mundshëm interesi vlerëson se kjo problematikë nuk passjell pasoja konkrete në procesin e rivlerësimit për subjektin<sup>97</sup>.

**33. Kursime nga të ardhurat nga paga për periudhën 2014 - 2015** (shuma 200.000 lekë për vitin 2014 dhe shuma 200.000 lekë për vitin 2015), shumë të cilën e disponon *cash* në shtëpi. Gjithsej: 400.000 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

### Hetimi i Komisionit

**33.1** Nga hetimi rezultoi se subjektit i rivlerësimit në deklaratat e saj periodike, prej vitit 2011 deri në deklaratën *Vetting*, nuk ka deklaruar kursime *cash*.

**33.2** Ndërsa bashkëshorti i saj, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012 (i deklaruar nga subjekti si bashkëjetues sepse martesë ligjore është bërë më 25.10.2013<sup>98</sup>) nuk rezulton të ketë deklaruar kursime *cash*. Ai ka deklaruar kursime *cash* për herë të parë në vitin 2014. Komisioni i ka paraqitur në tabelën e mëposhtme të dhënat e deklaruara nga bashkëshorti i subjektit.

**Tabela nr. 5**

Viti	Përshkrimi në DPV	Shuma në lekë
2012	<i>Nuk ka deklarim</i>	
2013	<i>Nuk ka deklarim</i>	
2014	<i>Kursime nga të ardhurat nga paga, shumë të cilën e disponoj gjendje cash në shtëpi</i>	200,000

<sup>96</sup> Kohë kur është transferuar me detyrë në Tiranë.

<sup>97</sup> Referuar edhe vendimeve të Kolegjit: nr. \*\*\*, datë 26.6.2020; nr. \*\*\*, datë 7.4.2022; nr. \*\*\*, datë 22.5.2019.

<sup>98</sup> Referuar certifikatës së martesës datë 8.1.2018, të Njësisë Administrative Tiranë \*\*\*, depozituar nga subjekti me pyetësin standard.

2015	<i>Kursime nga të ardhurat nga paga, shumë të cilën e disponoj gjendje cash në shtëpi ndërsa pjesa tjetër e pagës duke zbritur shumën 3544.24 lekë, e cila ka qenë gjendje e llogarisë së pagës në datë 31.12.2015 pranë BKT-së, është konsumuar për nevoja të familjes.</i>	200,000
2016	<i>Nuk ka deklarim</i>	
Vetting	<i>Kursime nga të ardhurat nga paga për periudhën 2014 – 2015 (në shumën 200.000 lekë për vitin 2014 dhe shumën 200.000 lekë për vitin 2015), shumë të cilën e disponoj cash në shtëpi. Gjithsej 400.000 lekë</i>	400,000

**33.3** Meqenëse bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit rezultoi të jetë subjekt deklarues, Komisioni ka administruar edhe dosjen e plotë të hetimit të ILDKPKI-së së bashkëshortit të subjektit, ku pjesë përbërëse janë edhe deklaratimet periodike të tij, të cilat gjithashtu ishin të administruara edhe në dosjen e subjektit të rivlerësimit.

**33.4** Nga verifikimi i deklaratave periodike të bashkëshortit të subjektit rezultoi se ai në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës (data e emërimit 5.10.2007) ka deklaruar: “*Gjendje cash e përfituar prej shitjes së një trualli me kontratë shitblerjeje, si dhe nga aktiviteti biznes i vogël ‘\*\*\*’, ushtruar me pjesëtar të familjes (vëllain). Vlera: 1.300.000 lekë*”.

**33.5** Prej deklaratimit të parë dhe deri në vitin 2013 nuk rezultoi asnjë deklarim, shtesa apo pakësime, lidhur me kursimet *cash*.

**33.6** Komisioni e ka pyetur<sup>99</sup> subjektin lidhur me kursimet *cash* të bashkëshortit, e cila në përgjigje ka deklaruar: “*Në lidhje me sa kërkohet deklarohet se pasi kam pyetur bashkëshortin më ka sqaruar se kjo shumë në vitin 2012 ka qenë 0 (zero). Shuma është konsumuar gradualisht gjatë viteve 2007 – 2012, derisa në vitin 2012 është bërë 0 (zero)*”.

**33.7** Komisionit, pasi kreu analizën financiare (sikurse paraqitet në tabelën më poshtë) duke e marrë gjendjen e kursimeve në vlerën 0 (zero) në vitin 2012, nuk i rezultuan problematika. Në të tilla kushte konstatohet se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë pasur mundësi financiare të krijojnë kursimet e deklaruara prej vitit 2014, si dhe të mbulojnë shpenzimet e tjera familjare.

**Tabela nr. 6**

Nr.	Përshkrimi	2014	2015	2016
<b>1</b>	<b>TË ARDHURA</b>	<b>1,700,460</b>	<b>2,142,849</b>	<b>2,442,339</b>
	Të ardhura nga paga subjekti	547,375	1,004,049	984,081
	Të ardhura nga paga bashkëshorti	1,015,669	1,030,636	1,052,448
	Të ardhura nga interesat	137,416	8,164	-
	Të ardhura nga shitja e automjetit tip “Peugeot”, me targa *** (datë 22.10.2015)	-	100,000	-
	Të ardhura nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz”, datë 10.2.2016, me targa ***	-	-	405,810
<b>2</b>	<b>SHPENZIME</b>	<b>1,416,665</b>	<b>9,057,076</b>	<b>2,033,749</b>

<sup>99</sup> Me pyetësin nr. 3, datë 10.11.2022, administruar në dosjen e Komisionit.

	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	879,992	1,629,900	2,033,749
	Shpenzime qiraje (nga nëntori i vitit 2013)	240,000	-	-
	Shpenzime mjekësore (lindje)	-	-	-
	Shpenzime blerje me kartë	296,673	-	-
	Transferuar shuma e depozitave te prindërit	-	7,427,175	-
<b>3</b>	<b>PASURI</b>	<b>66,399</b>	<b>(7,027,616)</b>	<b>(1,813)</b>
	<b>Pasuri e paluajtshme/e luajtshme</b>			
	Blerje automjeti tip “Volkswagen”, datë 10.12.2015, me targa ***	-	200,318	-
	<i>Ndryshim likuiditeti</i>	66,399	(7,227,933)	(1,813)
	<b>DIFERENCA (1-2-3)</b>	<b>217,396</b>	<b>113,389</b>	<b>410,402</b>

**34. Gjendje e llogarisë së pagës datë 19.1.2017, në vlerën 3.791,42 lekë.** Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës<sup>100</sup> vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 19.1.2017, të BKT-së, sipas të cilit shtetasi G.H ka llogari rrjedhëse me gjendje në datën 19.1.2017, në vlerën 3.791,42 lekë.

**34.1** BKT-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.8.2020, informon se shtetasi G.H ka llogari me gjendje 3.791,42 lekë, në datën 25.1.2017 (datën e dorëzimit të deklaratës *Vetting*).

**34.2** Trupi gjykues konstatoi se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e BKT-së.

### Gjetje të tjera

**35.** Nga korrespondenca e Komisionit me institucionet publike<sup>101</sup>, AMF, Policia e Shtetit për hyrjedaljet, Ministria e Drejtësisë, për sa i përket të dhënave të administruara në regjistrin noterial, nuk rezultuan problematika apo dyshime për përdorim automjetesh, dalje në sistemin *TIMS* me mjete të padeklaruara apo kontrata të nënshkruara përpara noterit publik nga/dhe në adresë të subjektit të rivlerësimit, përveçse atyre të identifikuar gjatë hetimit.

## B. KONTROLLI I FIGURËS

**36.** Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar raportin nr. \*\*\* prot., datë 31.10.2017, mbi kontrollin e figurës, deklasifikuar me vendimin nr. \*\*\*, datë 14.10.2022, të KDZH-së, për subjektin e rivlerësimit. Në këtë raport DSIK-ja, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të

<sup>100</sup> Aneks nr. \*\*\*, në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>101</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 31.8.2020 nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, shkresë nr. \*\*\* prot., datë 15.8.2020 nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 11.8.2020, nga Ministria e Drejtësisë.



ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar: *Përshatshmerinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Armida Hamiti.*

### **Hetimi Komisionit**

**36.1** Komisioni, në vijim, si organi i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të lartpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

**36.2** Nga informacioni i përditësuar<sup>102</sup> nga organet ligjzbatuese nuk rezultuan të dhëna të tjera lidhur me kriterin e kontrollit të figurës.

**36.3** Trupi gjykues, në kushtet që nga hetimi i kryer: (a) nuk konstatoi mangësi në lidhje me plotësimin e deklaratës së kontrollit të figurës apo vërtetësisë së të dhënave nga subjekti i rivlerësimit; (b) nuk evidentoi rrethana që mund të përbënin *indicie* për kontakte të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit apo të mund të cenonin figurën e subjektit, sipas dispozitave ligjore të kreut V të ligjit nr. 84/2016; (c) nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës – çmon se subjekti i rivlerësimit Armida Hamiti ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

## **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

**37.** Raporti i vlerësimit të aftësive profesionale<sup>103</sup> është përgatitur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**37.1** Raporti i vlerësimit profesional është mbështetur në: (i) formularin e vetëdeklarimit dhe tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit; (ii) të dhëna e dokumente që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; (iii) pesë dosjet gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; si dhe (iv) të dhënat nga burimet arkivore të KLP-së, pas të cilit është konkluduar në:

- a) aftësitë profesionale;
- b) aftësitë organizative;
- c) etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale;
- ç) aftësitë personale dhe angazhimin profesional.

---

<sup>102</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.4.2022 dhe nr. \*\*\* prot., datë 21.11.2022, informohet se nuk disponohen të dhëna të përditësuara për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme.

<sup>103</sup> Raport nr. \*\*\* prot., datë 11.10.2022, i KLP-së.

**37.2** Raporti i vlerësimit profesional<sup>104</sup>, në analizë të gjetjeve<sup>105</sup>, si dhe bazuar në të gjitha burimet e informacioneve për subjektin e rivlerësimit, nuk ka evidentuar problematika në aspektin e aftësive profesionale, organizative, etikën dhe integritetin e tij.

### **Analiza e gjetjeve**

**37.3** Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit: formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti; pesë dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; dhe të dhënave nga burimet arkivore në sektorin e burimeve njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme. Në funksion të qartësisë së analizës së gjetjeve, tri aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit referohen sipas radhës së paraqitura në pjesën I të këtij raporti, me termat “dokumenti 1, dokumenti 2, dokumenti 3”, ndërsa pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara referohen sipas radhës së paraqitura në pjesën II të këtij raporti, me termat “dosja 1, dosja 2, dosja 3, dosja 4 dhe dosja 5”.

#### **37.3.i Aftësitë profesionale**

##### *a) Njohuritë ligjore*

Subjekti i rivlerësimit, prokurorja Armida Hamiti, tregon korrektësi në zbatimin të ligjit. Në tri aktet procedurale ligjore të paraqitura prej saj dhe në pesë dosjet e vëzhguara sipas shortit, është konstatuar se subjekti ka identifikuar normën ligjore të zbatueshme në të gjitha rastet. Në shumicën e rasteve analizon normën penale dhe procedurale penale të zbatueshme, duke e harmonizuar atë me faktin penal apo rrethanat që përcaktojnë masën e dënimit.

Është konstatuar se ka respektuar parashikimet ligjore dhe ato nënligjore. Aktet janë përgatitur në respektim të dispozitave procedurale penale dhe urdhrit nr. \*\*\*, datë 5.9.2003, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për pasqyrimin me shkrim të qëndrimit të prokurorit në seancë gjyqësore”. Aktet e përpiluara prej saj janë administruar në sekretarinë e prokurorisë, në respektim të plotë të urdhrit. Në vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, prokurores Armida Hamiti, për vitet 2014, 2015 dhe 2016 të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm rezultojnë se: (i) për vitin 2014 subjekti Armida Hamiti nuk është vlerësuar pasi ka qenë me leje lindjeje; (ii) për vitin 2015 subjekti Armida Hamiti është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë profesionale të treguara prej saj; dhe (iii) për vitin 2016 subjekti Armida Hamiti është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë profesionale të treguara prej saj.

##### *b) Arsyetimi ligjor*

Subjekti i rivlerësimit Armida Hamiti shfaq aftësi në arsyetim ligjor. Aktet e arsyetuara prej saj janë të kuptueshme. Nga pikëpamja gjuhësore ka respektuar rregullat e drejtshkrimit dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të aktit të përgatitur prej saj. Aktet e përpiluara prej saj janë të konceptuara përgjithësisht me tri pjesë. Përmbajtja e akteve u ka dhënë përgjigje çështjeve të parashtruara për zgjidhje. Në përmbajtjen e tyre (akteve) formohet lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve të arritura nga prokurori. Rezultojnë se konkluzioni i prokurorit, në aspektin arsyetues, lidhur me konstatimin e faktit penal mbështetet në analizimin dhe argumentimin e përgjithshëm të pasqyruar në një paragraf. Vlen të theksohet se subjekti i rivlerësimit ka analizuar dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me mënyrën e caktimit të

<sup>104</sup> Për më shumë të dhëna e detaje subjekti mund t'i referohet raportit të vlerësimit profesional të përgatitur nga KLP-ja, dokument i cili administrohet në dosjet e hetimit administrativ të Komisionit.

<sup>105</sup> Bazuar në kriteret ligjore të parashikuara nga nenet 73-76 të ligjit nr. 96/2016.

dënimit, parashikuar nga neni 47 i Kodit Penal. Niveli i arsytimit të akteve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

### **37.3.ii Aftësitë organizative**

#### *a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë*

Subjekti rivlerësimi, në periudhën e rivlerësimit tetor 2015 dhe deri aktualisht, ushtron funksionin e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në periudhën tetor 2012 – tetor 2015 subjekti i rivlerësimit Armida Hamiti ka ushtruar funksionin e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Prokurorja Armida Hamiti në periudhën e rivlerësimit ka deklaruar se i janë caktuar 200 çështje, nga të cilat 136 procedime penale dhe 46 mosfillime, si dhe 340 kërkesa penale të caktuara. Në vitin 2014 subjekti i rivlerësimit ka qenë me leje lindjeje. Subjekti i rivlerësimit Armida Hamiti ka ushtruar kompetencat që ligji i njeh prokurorit, në drejtim të ushtrimit të ndjekjes penale, kontrollit dhe mbikëqyrjes së policisë gjyqësore. Prokurorja ka kryer detyrat e saj në pajtim me pikat 2 dhe 2.1 të urdhrin nr. 147, datë 9.5.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm, “Për unifikimin e ushtrimit të funksioneve në prokuroritë e shkallës së parë”, që përcakton se vendimi i mosfillimit të procedimit, vendimi i pushimit të çështjes, kërkesa për caktimin e masës së sigurimit personal, vendimi i zgjatjes së afatit të hetimeve, kërkesa për gjykimin e çështjes, konkluzionet përfundimtare dhe urdhrat në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale formulohen, arsyetohen dhe nënshkruhen nga prokurori i çështjes dhe detyrimin e prokurorit të çështjes për të diskutuar paraprakisht me Drejtuesin e Prokurorisë. Nga analiza e pesë çështjeve të përzgjedhura me short, qëndrimi i saj ka qenë në përgjithësi brenda afateve, sipas kërkesave të ligjit procedural penal. Subjekti i rivlerësimit, në respektim të afateve procedurale, ka paraqitur qëndrimin e saj para gjykatës dhe nuk është bërë ndonjëherë shkak për shtyrjen e gjykimeve, për mospërgatitjen e tij për çështjen në gjykim. Me udhëzimin nr. 3, datë 19.6.2012, “Për një ndryshim dhe një shtesë në udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005, ‘Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale’ i ndryshuar”, të Prokurorit të Përgjithshëm, është përcaktuar, ndër të tjera, se vendimi i mosfillimit të procedimit penal duhet të merret brenda afatit 30-ditor nga prokurori i çështjes. Analiza e të dhënave është bërë në referencë të ligjit procedural penal, Kushtetutës dhe KEDNJ-së, të cilat vendosin detyrimin për respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. Lidhur me efektivitetin në aspektin sasior në raport me kohëzgjatjen e trajtimit të çështjeve dhe kërkesave të ndryshme penale, prokurori subjekt rivlerësimi ka përballuar ngarkesën e punës me efikasitet. Në analizë të të dhënave të mësipërme konstatohet se subjekti i rivlerësimit, prokurorja Armida Hamiti, është efiçente dhe efektive. Në këtë drejtim duhet evidentuar se koha është një aspekt i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor.

#### *b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore*

Subjekti i rivlerësimit, prokurorja Armida Hamiti, merr pjesë në gjykim, si palë, duke përfaqësuar Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Konstatohet se tregon profesionalizëm në gjykim dhe me qëndrimin që mban për çështjet në gjykim.

#### *c) Aftësia për të administruar dosjet*

Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short konstatohet se dosjet janë të administruara rregullisht, materialet janë të vendosura në rend kronologjik, të njohin me faktin penal, me qëndrimin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor dhe disponimin e gjykatës.

### **37.3.iii Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale**

#### *a) Etika në punë*

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, prokurorja Armida Hamiti, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit ushtron detyrën e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Nga aktet e përzgjedhura nga subjekti, si dhe nga dosjet e hedhura në short, ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit. Nga verifikimi në sektorin e burimeve njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme rezultoi se për periudhën e rivlerësimit, tetor 2013 – tetor 2016, për subjektin e rivlerësimit, prokuroren Armida Hamiti, nuk është marrë asnjë masë disiplinore.

#### *b) Integriteti*

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, prokurorja Armida Hamiti, si dhe nga pesë dosjet e vëzhguara sipas shortit, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

#### *c) Paanësia*

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit. Në asnjë prej pesë dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak anësie të dokumentuar. Nga ana tjetër, asnjë prej tri dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në tri dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave.

### **37.3.iv Aftësitë personale dhe angazhimi profesional**

#### *a) Aftësitë e komunikimit*

Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara në format letër dhe në tri dokumentet e dorëzuara prej saj, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

#### *b) Aftësia për të bashkëpunuar*

Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën e prokurorisë, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Nga vlerësimet e punës së subjektit për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të kryera nga Prokurori i Përgjithshëm rezulton se: (i) për vitin 2014 subjekti nuk është vlerësuar, pasi ka qenë me leje lindjeje; (ii) për vitin 2015 subjekti është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë e bashkëpunimit të treguara prej saj në raport me institucionet e tjera ligjzbatuese, publikun dhe personat e tretë; (iii) për vitin 2016 subjekti është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë e bashkëpunimit të treguara prej saj në raport me institucionet e tjera ligjzbatuese, publikun dhe personat e tretë.

#### *c) Gatishmëria për t'u angazhuar*

Subjekti i rivlerësimit, prokurorja Armida Hamiti, i nënshtrohet Programit të Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në periudhën e rivlerësimit deklaroi se është angazhuar në aktivitete profesionale.

## **C/1. Rivlerësimi i aftësive profesionale**

**38.** Nga analizimi i të gjitha dokumenteve ligjore<sup>106</sup> të administruara dhe akteve të hartuara<sup>107</sup> nga subjekti i rivlerësimit, pas të cilëve është përgatitur edhe raporti përkatës, nuk u vërejtën problematika në lidhje me rivlerësimin e këtij kriteri.

**38.1** Po ashtu, nuk u konstatuan problematika në lidhje me etikën, integritetin dhe paanësinë e subjektit të rivlerësimit në ushtrimin e detyrës së tij funksionale.

**38.2** Komisioni i kërkoi informacion edhe ILD-së lidhur me propozimin e ndonjë procedimi disiplinor ndaj subjektit të rivlerësimit lidhur me çështjen që i përket dosjes së ekstradimit të shtetasit N.S, për të cilën ka konfirmuar<sup>108</sup> se ndaj subjektit nuk është filluar asnjë hetim disiplinor dhe nuk është paraqitur asnjë kërkesë për procedim disiplinor pranë KLP-së.

## **Të dhëna nga burime arkivore**

**39.** Nga verifikimi i të dhënave nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, si dhe të burimeve arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, rezulton se subjekti Armida Hamiti:

- Nuk ka pasur masa disiplinore.
- Nuk ka të dhëna apo *indicie* të ardhura nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshime në kuptimin penal dhe atë të cenimit të figurës së subjektit të rivlerësimit për përfshirje drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta.
- Ndaj subjektit të rivlerësimit nuk ka materiale hetimore të regjistruara në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë.
- Ndaj subjektit të rivlerësimit nuk ka ankesa apo kallëzime penale të regjistruara në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë dhe në Prokurorinë e Përgjithshme.

**40. Në lidhje me denoncimet e depozituara në Komision rezultoi se është paraqitur vetëm një denoncim<sup>109</sup> i shtetasit K.M.**

**40.1** Denoncuesi K.M ankohet lidhur me: hetimin e procedimit penal nr. \*\*\*, procedim që ka të bëjë me veprën penale “shkelje të rregullave të mbrojtjes në punë”; dhe se subjekti nuk i ka vendosur në dispozicion akte të dosjes të kërkuara prej tij. Bashkëngjitur, denoncuesi ka depozituar

<sup>106</sup> Vendim për mosfillimin e procedimit penal nr. \*\*\*, datë 15.11.2016, kërkesë për miratimin e lejimit të ekstradimit të shtetasit shqiptar A.E.L, datë 29.6.2016, konkluzione përfundimtare për ekstradimin e shtetasit italian S.B datë 15.12.2015.

<sup>107</sup> Dosja 1/kallëzimi penal nr. \*\*\*, datë regjistrimi 17.2.2015, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Objekti i shortit: dokumenti ligjor – vendim “Për mosfillimin e procedimit penal”, datë 10.4.2015, për kallëzimin penal nr. \*\*\*, datë 17.2.2015; dosja 2/procedimi penal nr. \*\*\*, regjistruar në datën 12.4.2013, për veprën penale “mosbindje ndaj urdhrin të punonjësit të policisë së rendit publik”, parashikuar nga neni 242 i Kodit Penal, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Objekti i shortit: dokumenti ligjor – vendim “Për pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, të vitit 2013”, datë 11.10.2013, hartuar nga prokurorja Armida Hamiti, subjekt rivlerësimi; dosja 3/procedimi penal nr. \*\*\*, regjistruar në datën 9.3.2015, me të pandehur M.K, akuzuar për veprën penale “prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve të gjuetisë”, parashikuar nga neni 280 i Kodit Penal, dërguar për gjykim në datën 3.4.2015. Objekti i shortit: dokumenti ligjor – kërkesë “Për gjykimin e çështjes”, datë 3.4.2015, përgatitur nga prokurorja Armida Hamiti, subjekt rivlerësimi; dosja 4/praktika e ekzekutimit të aktit nr. \*\*\*, datë 3.6.2016. Objekti i shortit: dokumenti ligjor – kërkesë “Për ekzekutimin e letërporosisë së autoriteteve të drejtësisë së Malit të Zi”, përgatitur nga prokurorja Armida Hamiti, subjekt rivlerësimi; dosja 5/praktika e ekzekutimit të aktit nr. \*\*\*, datë 25.5.2016. Objekti i shortit: dokumenti ligjor – kërkesë “Për njohjen e vendimit penal nr. \*\*\*, datë 14.4.2008, të Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda Milano ndaj shtetasit G.K”, përgatitur nga prokurorja Armida Hamiti, subjekt rivlerësimi.

<sup>108</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.11.2022.

<sup>109</sup> Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 19.9.2019.

kthim përgjigjen nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në të cilën vërehet se i njoftohet vendimmarrja për tërheqjen e kërkesës dhe vazhdimi i hetimeve duke i dërguar aktet në autoritetet e drejtësisë së Malit të Zi.

**40.2** Komisioni i kërkoi Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë kopje të fashikullit penal për çështjen objekt ankimi, për të cilën kjo e fundit<sup>110</sup> ka konfirmuar se nuk disponon kopje të akteve të këtij fashikulli, pasi kopja origjinale i është dërguar autoriteteve të drejtësisë së Malit të Zi, me qëllim vazhdimin e hetimeve prej tyre për shkak se hetohej për një veprë penale të ndodhur në territorin e këtij shteti.

**40.3** Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime lidhur me pretendimin e denoncuesit.

**40.3.i** Subjekti në prapësime ka qartësuar pozitën e denoncuesit në këtë procedim penal si viktimë e veprës penale. Subjekti ka parashtruar se argumentet që kishte përdorur shteti kërkues, në këtë rast Mali i Zi, për të transferuar në Shqipëri këtë procedim penal, kanë qenë dy: së pari, viktimja e veprës penale ishte shtetas shqiptar, shtetasi K.M dhe, së dyti, personi juridik ndaj të cilit mund të zhvilloheshin hetimet, personi me të cilin viktimja e veprës penale kishte lidhur një kontratë pune (sezonale) ishte një shoqëri e huaj sh.p.k. për llogari të së cilës shtetasi K.M do të punonte në Malin e Zi. Sipas subjektit, shoqëria e huaj kishte një degë – filial në Shqipëri, ndërsa shoqëria mëmë e kishte Selinë kryesore në Maqedoninë e Veriut. Subjekti ka shpjeguar se në kuadër të këtij procedimi kishin administruar të dhëna mbi statusin e shoqërisë, objektin, selinë e saj, në QKB – Qendra Kombëtare e Biznesit. Nga të dhënat kishte rezultuar se kjo shoqëri ishte me aktivitet të pezulluar prej disa kohësh (referuar kohës kur janë kryer verifikimet). Subjekti ka konfirmuar se nga verifikimet e kryera kishte rezultuar se adresa që gjendej në të dhënat e regjistrit të QKB-së nuk rezultonte të ishte më. Ky fakt ishte provuar nga shënimi që kishte bërë postieri në fletëthirrjen që kishin dërguar, me qëllim njoftimin dhe paraqitjen përpara organit të prokurorisë, me qëllim për të dhënë deklarime administratori i shoqërisë. Shërbimi postar kishte bërë shënimin që në atë adresë ndodhej një individ tjetër dhe se shoqëria që kërkonin kishte kohë që ishte larguar.

**40.3.ii** Në këto kushte, subjekti ka sqaruar se duke qenë që personi juridik ndaj të cilit do të zhvilloheshin hetimet ishte i huaj, nuk gjendej dhe nuk kishte një adresë zyrtare të deklaruar në territorin e Republikës së Shqipërisë, organi i procedimit kishte konkluduar se nuk mund të vazhdonte të kryente hetime për një fakt penal, i cili kishte ndodhur jashtë territorit shqiptar dhe personi që dyshohej si autor ishte një person juridik i huaj që kishte pezulluar aktivitetin tregtar në Shqipëri, nuk ndodhej brenda kufijve të territorit shqiptar dhe nuk kishte një adresë banimi të deklaruar në Shqipëri dhe, për pasojë, autoritetet shqiptare nuk ishin më kompetente nga pikëpamja e kompetencës territoriale për të vazhduar hetimet në lidhje me këtë fakt.

**40.3.iii** Subjekti ka referuar edhe legjisllacionin<sup>111</sup> mbi të cilin ishte bazuar ndjekja e kësaj procedure, ku ishte vendosur: (i) tërheqja e pranimit të kërkesës në kuadër të procedimit penal nr. \*\*\*; (ii) njoftimi i këtij vendimi Ministrisë së Drejtësisë për procedimin e mëtejshëm; (iii) dërgimi i akteve që i përkasin procedimit penal nr. \*\*\* autoriteteve të drejtësisë të Malit të Zi.

**40.4** Trupi gjykues, pas analizimit të denoncimit të depozituar, referuar nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

<sup>110</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 23.11.2022.

<sup>111</sup> Bazuar në nenin 12 të Konventës së Këshillit të Evropës “Për Transferimin e Procedimeve në Çështjet Penale” në të cilin parashikohet se: “Neni 12, paragrafi 2, germa ‘a’, 2. Shteti i kërkuar mund të tërheqë pranimin e kërkesës:(a) në qoftë së bëhet e qartë që prania personale e personit të dyshuar nuk mund të sigurohet në seancat e procedimeve në atë shtet ose që çdo dënim, i cili mund të jetë kryer, nuk mund të kërkohet të zbatohet në atë shtet”.

shpjegimeve të subjektit bazuar në legjislacion, por edhe në kushtet që konstatoi se denoncuesit, organi i akuzës i ka kthyer përgjigje duke e njoftuar lidhur me vijimësinë e procesit hetimor, vlerëson se në tërësi nuk konstatohen problematika që ndikojnë në lidhje me kriterin e rivlerësimit të subjektit në aspektin e tij profesional.

**41.** Në përfundim, trupi gjykues i Komisionit, pasi shqyrtoi kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale, sipas parashikimit të pikës 2 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pas propozimit të relatores së çështjes, çmon se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, në përmbushje të parashikimit të germës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016 dhe, për këtë shkak, konsiderohet “e aftë”.

### **VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara prej tij, çmon se:

- a. Lidhur me kriterin e pasurisë, bazuar në parimin e proporcionalitetit dhe referuar jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, çmon se subjekti ka arritur nivel të besueshëm në kriterin e pasurisë.
- b. Lidhur me kriterin e kontrollit të figurës, trupit gjykues nuk i rezultuan elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës apo elemente të tjera që mund të cenojnë figurën e subjektit.
- c. Lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, duke marrë parasysh qëllimin e vlerësimit të aftësive profesionale, siç parashikohet nga Kushtetuta, trupi gjykues, në mungesë të evidentimit të ndonjë mangësie apo defekti, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të germës “a” të pikës 1 të nenit 58, si dhe të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti plotëson kushtet e nenit 59/1,

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Armida Hamiti (Moçka), prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
  4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
- Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 21.12.2022.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Roland ILIA**  
**Kryesues**

**Brunilda BEKTESHI**  
**Relatore**

**Pamela QIRKO**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Albana Plaka*